

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXIII i botimit, nr. 257, Mars 2025

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Viti 2025, 100-vjetorit të lindjes së Albanalogut Martin Camaj "Nderi i Kombit"



Viti 2025, viti zgjedhor, për në Kuvendin Shqiptar



*Gerta Gjoni - Bardeli, në listën e mbyllur,
që kandidon për PD*



*Marjana Koçeku,
që kandidon për PS, në listë të mbyllur,*



Elmira Ndrevasaj, që kandidon për PL në listë të hapur



*Gerta Gjoni - Bardeli, në listën e mbyllur,
që kandidon për PD*



*Ndoc Ashta, në listën e hapur,
që kandidon për PD*



*Elmira Ndivashaj, që kandidon për PL në
listë të hapur*



*Tonin Çermeli, që kandidon për Partinë
Lëvizja Bashkë, në listë të hapur*



*Ardian Merla, që kandidon për
Partinë Lëvizja e Atdheut,
në listë të hapur,*



*Arben Gjuraj, që kandidon për Partinë
Koalicionin Euroatlantik, në listë të hapur,*



*Franc Shkambi, që kandidon për
Partinë Koalicionin Euroatlantik,
në listë të hapur*



*Marjana Koçeku,
që kandidon për PS,
në listë të mbyllur,*




*Marjan Ndershtiqaj,
që kandidon për PS, në listë të hapur*



*Elvis Deda, që kandidon për
Partinë Mundësia në listë të mbyllur*



*Lulash Gjinesha,
që kandidon për PSD, në listë të hapur, i treti*



*Miran Pali,
që kandidon për PSD,
në listë të hapur*

Princi Lekë Dukagjini, bir i Pavdeksisë

- esse -

Në maje të Jezercës kreshtë thepisun ku ajri i pastër përshkon çdo cep të masivit të bronzte e tue zbrit poshtë varoshit halat qepallëgjelbra të pishave fryjnë me një melodi të lum-bueshe. Atje endet si vegim një shpirt i lashtë që e pat lidhë emni e vet me gjithçka të shenjtë të atdheut arbërorë

Lekë Dukagjini një burrë i përsosun, me flokët të errët që ndriçojnë nën rrezet e diellit të pasdites, me sy që shkëlqejnë si dy yje të zjarrtë. Balli i gjanë dhe i sheshtë me fytyrë të pastër shëmbëllim i forcës dhe mençurisë, së një udhëheqësi të fuqishëm dhe të vendosun. Mustaqe të trasha vesh më vesh, me në një tonalitet që përputhej me flokët e tij të errtë. Azgan, me pamje aristokratike të përshtatshme për statusin e tij të lartë, veshur hijshëm si kombinim i fuqisë, elegancës, fisnikërisë, por edhe gatishmërisë e tij për të udhëheqë dhe mbrojtë principatën e Dukagjinit. Çdo hap i tij ishte si një betim i vendosun, mburoje nderi dhe lavdie.

Një burrë i fortë, i qetë që në çdo situatë, mbante mbi supe jo vetëm peshën e nderit të të parëve por dhe ëndrrat e popullit liridashës. Ngjeshun dhe stolisun me armët e tij të ndritshme, Lekë Dukagjini ndiente në çdo shikim të tij një thirrje për drejtësi dhe liri. Lidhja me tokën, me dritën e natyrës që kishte mbrojtun ishte ma shumë se një detyrim, por edhe një pasion që rridhte nëpër damarët e tij, që e banë gjithmonë të qëndronte



Xhulian Marku,
që kandidon për PSD
në listë të hapur

i patrembun dhe i palëkundun. Ai nuk ishte thjesht një udhëheqës, por edhe një pasqyrë e vlerave të pakrahueshme që ruanin lidhjen e ngushtë mes nderit të luftëtarëve dhe dashurisë për atdheun. Emri i tij tingëllonte si një melodie e bukur dhe e fuqishme, që frymëzonte jo vetëm luftë, por edhe shpresë për të ardhmen dhe kushtim kryengritës në çdo rrezik. Lekë Dukagjini asht një figurë e pakrahueshme, që përjetëson luftën e lavdishme dhe andrrën e lirisë, për çdo shqiptar, simbol i pavdekshëm i heroizmit dhe nderit.

Lekë Dukagjini jo vetëm Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë së pathyeshme arbërore për më se një dekadë, por edhe si një prijës shpirtëror dhe moral i shqiptarëve, sidomos në periudhën e mesjetës. Ai ishte një njeriu që e udhëhoqi popullin e tij jo vetëm me forcën e armëve, por edhe me mençurinë dhe drejtësinë që tregonte. Një nga aspektet më të spikatuna të personalitetit të tij ishte ndjenja e thellë e drejtësisë dhe pasioni i tij për ruajtjen e traditave të popullit të tij. Kanuni i Lekë Dukagjinit, i njohur edhe si "Kanuni i Dukagjinëve", asht një nga më të rëndësishmit dhe më të vjetrit e legjislacionit shqiptarë dhe më gjanë në rajon. Ky kanun mbante parasysh jo vetëm ligjet dhe normat shoqërore, por gjithashtu shpërndante urtësi shpirtnore dhe ndihmonte në forcimin e bashkëjetesës dhe unitetit të komunitetit.

Në kuadrin e shoqërisë tradicionale shqiptare, Lekë Dukagjini shihej si një simbol i autoritetit moral, një prijës që udhëhoqi me përlësi dhe dashuri për njerëzit e tij. Ai ishte i njohur për ndershmërinë dhe mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe grupeve, dhe ishte një figurë që kërkonte drejtësi, jo vetëm për vetveten, por edhe për popullin e tij. Ai ishte një mbrojtës i jetës së thjeshtë dhe të ndershme, një udhëheqës që e vendosi moralin dhe dinjitetin e popullit të tij mbi çdo interes tjetër. Në thelb, Lekë Dukagjini ishte një figurë e rëndësishme jo vetëm për aftësitë e tij ushtarake, por edhe për rolin e tij si prijës shpirtëror. Ai mbeti një udhëheqës që frymëzoi dhe që ka vazhduar të kujtohet dhe nderohet për shekuj me radhë, si një nga figurat më të mëdha të historisë dhe shpirtit shqiptar.

FLUTURIMI NË PERJETESI

Në natën e errët, kur yjet ndriçojnë me një dritë të hollë dhe të qetë,



Princi Lekë Dukagjini
Pikturë nga Mjeshtri i Madh, Zef Shoshi

dhe bora mbulonte malet me një petk të bardhë e të shenjtë, Lekë Dukagjini, udhëheqësi i pavdekshëm, i ngjizun me shpirtin e këtij dheu të lashtë, ngriti sytë lart, drejt qiellit të pafund. Aty, mes ylberit dhe diellit që po zbeheshin, ndjeu thirrjen e pafundësisë, thirrjen që i vinte nga ato male që kishte mbrojtun dhe dashtë gjithë jetën. Në këtë çast të magjishëm, kur frymëmarrja e natyrës ishte si një melodi e hesh-tun, ai shtriu krahët. Drita që buronte nga shpirti i tij u ba flakë e zjarrtë që ndriçoi gjithë errësirën rreth tij. Biri i tokës dhe zogu i natyrës u ngrit në qiell dhe u shkëput nga toka që kishte mbrojt për aq shumë kohë. Nuk ishte ma një njeri, por një shpirt i lirë, që fluturonte në përjetësi. Fluturimi i tij ishte i lehtë, si një shenjë e ajrit, e cila bashkohej me retë shtëllungore tue kalue mbi luginat e thella dhe malet e larta të Dukagjinëve, aty ku çdo gjethe dhe çdo rrëke përmendnin emrin e tij. Ai lëvizte si një dritë, paqe, i çliruem nga çdo mundim, e mbushun me lavdinë e asaj që kishte lënë

pas. Në këtë fluturim, Lekë Dukagjini nuk ishte thjesht një hero i kalimeve të mundimshme. Ai ishte shejzë përjetësie e një udhëheqësi, i cili ndërsa ngjitej drejt qiellit, nuk e humbiste asnjëherë lidhjen me popullin që kishte dashtë dhe mbrojtë. Ai fluturoi drejt Parajsës dhe u bashkua me të gjitha shpirtat e shenjtë. U ba një me ajrin dhe natyrën, ku do të qëndronte përgjithmonë në mendjet dhe zemrat shqiptare. Ky fluturim nuk ishte fund, por një kalim në një tjetër dimension, ku legjenda bahej e gjallë dhe lavdia e tij shndriste si një yll, që nuk do të zbehej kurrë. Ai ishte i pafund, si vetë historia e tij, dhe do të fluturonte përgjithmonë, nëpër malet e Dukagjinëve, për të qenë gjithmonë një prijës shpirtëror që do të frymëzonte breza më radhë!

PRELË MILANI

Njoftim!

Të nderuar anëtar të Kryesisë së SHAD!

Të nderuar anëtar të SHAD!

Të nderuar dukagjinas kudo ndodheni!

Të nderuar miq të SHAD e të Dukagjinit!

Sot, me 15 mars 2025, u bë një takim me N/kryetaret e SHAD dhe 2-3 anëtar të kryesisë, si dhe themelues të SHAD, me teme: "Ecuria e SHAD, në realizimin e misionit të saj, për vitin 2025!"

Viti 2025 mendojmë se ka fillua mjaft mbare, zona e Dukagjinit ka 14 kandidatura për deputet, zj. Gerta Bardeli, znj. Marjana Koçeku, z. Ndoc Ashta, z. Marjan Ndershtiqni, znj. Elmira Ndrevashaj, z. Tonin Çermeli, z. Ardian Merla, z. Arben Gjuraj e z. Franc Shkambi, z. Adnan Shullani e z. Elvis Deda, z. Lulash Gjinesha, Xhulian Marku dhe z. Miran Pali. Dy prej tyre janë të sigurte; zj. Gerta Bardeli e znj. Marjana Koçeku.

Falenderuam anëtarët e SHAD, z. Prele Shytani e Kole Çardaku, që me rastin e festes së Mesuesit, 7 Mars, kanë organizuar e realizua veprimtarinë, me teme: "Takim mësuesi pensionist!"

Në mes të tjerave u diskutua mbi detyrat që na dalin për këtë vit:

Së pari, veprimtaria kushtuar 22 vjetorit të themelimit të SHAD, e cila do të zhvillohet, me datën 17 maj 2025;

Së dyti, muaji korrik 2025, është me shumë ngjarje përkujtimore:

1.115 vjetori i Luftës së qafës së Agrit, me 10 korrik 1910, ku Pashaj më i fuqishëm Turk, u thye dhe u detyrua, për të hy në Shkodër, të kaloi nga Puka, e cila duhet përkujtuar në qafe të Agrit dhe kryesisht duhet bashkëpunimi me Njësinë Administrative Shale e Shosh;

2.110 vjetori i përballjes së Dukagjinit me ushtrinë malazeze, ku janë vrare 106 vete, me në krye Mehmet Shpendin, dhe kryesisht në Plan – Gjuraj, kane ra 81 persona, me 15 korrik 1915, e cila përkujtohet në Qeresh dhe kryesisht Njësia administrative Pult:

3.110 vjetori i rënies së Atdhetarit Mehmet Shpendit – Nderi I Kombit, i cili duhet përkujtua me 16 korrik, pranë Monumentit të tij ...

4.100 vjetori i lindjes së Albanologut Martin Camaj – Nderi I Kombit, me datën 25 korrik. Gazeta "Dukagjini", në nderim të jetës e veprës së tij, në secilin numër të saj, në faqe të pare duhet të theksoi: "Viti 2025, 100 vjetori i lindjes së Albanologut Martin Camaj – Nderi I Kombit"

N/kryetari i SHAD, Kolë Çardaku e Prele Milani, duhet të bashkëpunojnë me administratoret e Njësive Administrative

Së treti, Pjesëmarrja në veprimtaritë e shoqatave analoge:

1. Te shoqata e Miqësisë Kosovë – Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" në Pejë, në muajin Prill 2025;

2. Te shoqata "Dita e Plisit", me 21 qershor 2025, në Suhareke dhe me 7 shtator 2025, në Kaçanik.

3. Dr. Mark Palnikaj – Anëtar Nderi i SHAD, në kuadrin e 100 vjetrit të rënies së Bajram Currit, ka botua një monografi për te dhe promovohet në Akademinë e Shkencave, në Tiranë, me 22 mars 2025, në orën 11.00 – Prele Milani;

4. Dega e Shoqatës "Mirëdita", në Shkodër, me datën 20 mars 2025, në sallën "Mikel Koliqi", në orën 10.00, zhvillojnë veprimtarinë kushtuar 75 vjetorit të lindjes së Kryetarit të saj, Zef Gjini – Mjeshtër I Madh – Kolë Çardaku ...

Së katërti, u njohën me takimin e Kryetarit të SHAD, me Kryetarin e Bashkisë Shkodër, z. Benet Beci dhe N/kryetaren e Bashkisë, zj. Teuta Qyteza, me të cilët u bisedua:

1. Miratimi i rregullores me kriteret e vlerësimit të figurave e personaliteteve të Shkodrës dhe vendosjes së busteve apo monumenteve të tyre dhe tani do të ngrihet komisioni përkatës. I kërkoi, që për problemet tona, të SHAD, të jete njeri nga ne, në këtë komision dhe u ra dakord.

2. Kryesia e SHAD, ka propozua Këshillit të Bashkisë Shkodër:

*Për marrjen e Statusit të Dëshmorit të rënëve në lufte për Pavarësinë e Shqipërisë dhe të rënëve në Luftën e Gurit të Kuq, në muajin prill 1941;

*Për dekorimin e figurave të Lidhjes së Prizrenit, Mark Lula- Vladaj, Marash Kola e Gjekë Gegës ...

*Për vendosjen e emrit të shkollës 9 vjeçare të Bardhajve, Profesor Kole Prela- Nderi i Kombit;

*Për vendosjen e Bustit të Princit të Leke Dukagjinit, mundësisht brenda muajit qershor 2025. Për të gjitha këto u mor dakortësia, dhe kemi bindjen e plote se Kryetari i Bashkisë z. Benet Beci do të realizojë të gjitha kërkesat tona, në momentin më të mundshëm të duhur.

Së pesti, ju bëjmë me dije, se deri në muajin dhjetor 2025, botimi i gazetës, është e paguar nga vëllezërit Zef, Kristjan e Kludjo Pali, me banim në komunën Cuneo – Itali, të cilëve u urojme me shprehjen popullore "Paçin e dhënçin!"

Së gjashti, as kush nuk ka të drejte të komunikojë apo të japi mendime, në emër të SHAD, përveç kryetarit të saj dhe ai, që autorizohet nga Kryetari.

Së shtati, SHAD në këto vite, që po bëhen 22 vite, ka punuar me përkushtim të madh, duke qenë në unitet të plote, dhe duhet të eci me këtë ndjesi, moto si deri tani "Mos pyet se çfarë bëri Dukagjini për mua, por pyet veten: Çfarë bëra unë për Dukagjinitin!"



Pensionistët dukagjinas të Asimit, në festën e 7 Marsit

Edhe në këtë vit, si vitin e kaluar, 138 vjetori i shkollës shqipe, 7 Marsi, i gjeti pensionistët dukagjinas të arsimit në një veprimtari të përbashkët në bar-restorant "Alderi", në Dobraq. U mbledhën të gjithë ata që kishin mundësi dhe festuam së bashku 7 Marsin, me moton: "Festojmë e kujtojmë!"

Mendojmë që kjo veprimtari të kthehet në një traditë e përhershme.

Ishte një pjesëmarrje relativisht e mirë: Gjyste Shyti, Prelë Shytani, Pashko Shytani, Martin Arra, Dalina Arra, Pashko Camaj, Zef Toka, Kolë Çardaku, Dedë Kodra, Mark Gjoni, Ndoc Odri, Drande Odri, Gjon Arrinaj, Zef Bari, Zef Poti, Marie Gila, Marie Musa, Ndokë Leka, Gjeloš Çardaku, Prenda Sogja, Pashko Kroniku, Tone Mëshi, Ndue Leka e Mhill Qerimi.

E gjithë veprimtaria u zhvillua midis nostalgjisë e zhgënjimit. Ishim nostalgjik, sepse duke shërbyer në të dy sistemet, për sa i përket arsimit vlerësojmë më shumë sistemin që lamë pas, sepse në qoftë se ka pas ndonjë të mirë ai sistem, ka qenë cilësia e shkollës, kujdesi i shtetit dhe autoriteti i mësuesit. Gjithçka ndërtohej mbi bazën e bashkëpunimit prind - mësues - nxënës dhe kjo sillte cilësinë e asimilimit të programit mësimor - edukativ. Nxënësit kishin nivel të lartë të dijes dhe mbi të gjitha ishin njerëz me veti e virtyte më të larta, larg veseve të keqja që manifestohen sot. Punuam me vetëmohim e ndërgjegje të lartë për konsolidimin e sistemit arsimor.

Në kapërcyell të sistemeve Dukagjini ka pas 5 shkolla të mesme të bashkuara, shkolla 9 vjeçare në çdo fshat e cikël të ulët në lagje të veçanta. Bëmë shumë sakrifica, duke vënë mbi gjithçka interesin e shkollës duke përballuar shumë vështirësi, por nuk e ndienim lodhjen, sepse munda jonë nuk shkonte kot. Me nxënësit tonë kemi qenë të gatshëm me konkurrues me shkollat më prestigjioze. Nxënësit dukagjinas bënë diferencën në sensin pozitiv kudo

që shkonin në shkollat profesionale apo universitet.

Në vitet 90- të arritëm që gjithë mësueset në shkollat e Dukagjinit të ishin vendas. Shumë herë sot na kaplon zhgënjimi e indinjata për nivelin e shkollës sot. Cilësia e përvetësimit të dijeve është në një nivel shumë të ulët. Nuk merret kush me problemet e përmbajtjes, duke filluar nga organet më të larta të arsimit e deri në bazë. Mungon kontrolli i cilësisë së asimilimit të dijeve shkencore. Shkollat janë kthyer në institucione burokratike. Bëhen eksperimente të ndryshme, gjithfarë formularësh e statistikash, ku çdo dokument bëhet online, deri edhe regjistrat, duke vënë në vështirësi mësues, prind e nxënës. Pra, një formalitet i paparë. Edhe mësueset, me formim jo të mjaftueshëm shkencor e metodik, duke parë këtë frymë që shteti ka fut në arsim, nuk e kanë në lartësinë e duhur ndërgjegjen dhe impenjimin në punë, sepse autoriteti e përkrahja e tyre ka arritur minimumin dhe kjo ka sjellë që të shtohen me përmasa galoponte analfabetët funksional.

Mësuesit pensionist nuk janë zëvendësuar denjësisht në misionin e tyre fisnik. Nxënësit, sidomos djemtë shkojnë në shkollë formalisht, rrinë me orar të reduktuar, pa çanta, edhe në i paçin, se në to ka gjithçka përveç librave.

E gjithë veprimtaria u karakterizua nga gazi e hareja. Mbasi u përshëndetën të pranishmit nga organizatorët, duke i uruar mirëseardhjen sidomos atyre që kishin 7 marsin e parë, duke i thanë që të kenë më shumë vite pensioni se vite pune. Një falënderim i veçantë iu dha pensionistes Gjyste Shyti, ku arsyeja e saj triumfoj ndaj opinionit të sëmurë. Moment prekës ishte kur u kujtuan pensionistët të ndarë nga jeta, që nga 7 marsi i kaluar si: mësuesi e drejtori model, poeti, studiuesi, shkrimtari e publicisti Luigj Shyti; mësuesi e drejtuesi Gjeloš Ndreshaj dhe mësuesja Dila Dardha. Ishte një drekë për t'u mbaj mend në sensin pozitiv. Shumë pjesëmarrës

treguan episode të ndryshme nga jeta e tyre në arsim, në shkolla të ndryshme ku kanë punuar. Më shumë me nota humorit si: Kolë Çardaku, Zef Bari, Pashko Camaj, Marie Gila, Zef Toka e të tjerë. Kur telekronisti e pyeti hokatarin Zef Bari se si e përkufizon mësuesin ai tha: "Në sistemin e kaluar mësuesi është quajtur pishtar që prodhon dritën e dijes, kurse sot s' ka mbet as bishtuk!"; duke u nisur nga autoriteti që ka.

Dukagjini ka një armatë të madhe pensionistësh, që kanë punuar një jetë të tërë për masivizimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor, duke punuar fshat në fshat dhe përballuar me shumë sakrifica vështirësitë e punës.

Në këtë veprimtari të ditës së mësuesit, munguan më shumë se gjysma për arsye objektive, subjektive apo sëmundje, të cilët janë: Ndue Qerimi, Pal Kroni, Pashkë Kroni, Tomë Bungaja, Lenë Bungaja, Prenda Quku, Zojë Vuksani, Luk Dreni, Luke Shullani, Nikollë Gjoka, Pashko Ara, Zogë Ara, Groshe Ara, Sykë Qarku, Lenë Tthermja, Dedë Preka, Fran Çardaku, Kolë Gjoka, Tone Ballza, Tereze Brigja, Gjyste Nika, Pal Bregu, Gjokë Verrishta, Lena Fusha, Marie Livadhi, Ndoc Prenushi, Lazër Mhilli, Sugare Ibra, Mire Molla, Mhill Shkalla, Ndue Vata, Gjyste Vata e File Guri. Edhe këtyre ju urojmë që të kenë shumë 7 marsi të tjerë më aktiv, sepse një pjesë bëjnë një jetë shumë pasive e të mbyllur, që është edhe në dëm të shëndetit.

Një urim të veçantë i bëjmë pensionistit më të vjetër momentalisht, z. Ndue Qerim Quku, të cilit i urojmë shëndet të plotë.

Në çdo 7 mars përulemi me respekt për të gjithë ata mësues dukagjinas që nuk jetojnë më, por që dhanë një ndihmesë e kontribut të madh, që në zhdukjen e analfabetizmit dhe përhapjen e dijes ndër nxënësit dukagjinas, të cilët janë: Prelë Grima, Ndoc Grima, Shkurte Grima, Prenda Pjetri, Mirash Ndreza, Ndue Ndreza, Gjokë Pjetra, Ndue Pjetra, Age Gjoka, Mhill

Leka, Dedë Mrapshtia, Gjeloš Ndreshaj, Lazër Fusha, Zef Fusha, Prelë Bregu, Ndue Bregu, Violeta Zyla, Fran Dardha, Dila Dardha, Prelë Vuksani, Marash Miruku, Tonin Kshtoja, Ndue Çuni, Pjetër Selimi, Luigj Shyti, Kolë Funiçl, Prekë Sokoli, Ndue Kroni, Gjergj Kroni, Prekë Simoni, Lulash Ndoc Gila, Zef Livadhi, Pashko Biga e Nikollë Heba.

Këtë veprimtari na e pasqyroj me profesionalizëm në mediat lokale, djali i Shllakut e dhëndëri i Shalës i palodhuri Mark Gjeka.

Bukurinë kësaj veprimtarie ja shtoj mjedisi, në të cilin u zhvillua, bar - restorant "Arledi", në Dobraq, shërbimi i shpejtë dhe i kulturuar, ushqimi cilësor me një shumëllojshmëri sipas traditës nga vime si dhe çmimet e arsyeshme.

Në këtë shkrim u përmendën shumë emra pensionistësh të gjallë apo të ndarë nga jeta, por kërkoj ndjesë nëse kemi haruar ndonjë, gjë të cilën do t'a ndreqim në të ardhmen. Të gjithë pensionistëve dukagjinas, këtyre misionarëve të dijes, të cilët e kanë kryer më së miri detyrën e shenjë, duke e rritë cilësisht dhe konsoliduar shkollën, duke nxjerr nga duart e tyre shumë nxënës të mrekullueshëm, te shpërndarë anembanë vendit e botës, ju urojmë që t'i kemi edhe shumë dekada midis nesh, duke mos na munguar në asnjë festë apo veprimtari. Të kenë shëndet të plotë, të jenë sa më aktiv e të afrueshëm me njëri - tjetrin, sepse pasiviteti e mbyllja në vetvete jua shkurton vitet. Dëshirojmë që bashkësisë së pensionistëve dukagjinas të arsimit, t'i shtohen element të rinj, por duke mos ju shkaput asnjë element.

Jemi të keqardhur që 138 vjetori i shkollës shqipe e gjen arsimin në Dukagjin si mos më keq. Nxënës me pikatore nga shpopullimi, ato shkolla që ekzistojnë janë në gjendje mjerane. Kjo duhet të jetë shqetësim i politikanëve dhe instancave shtetërore të të gjitha niveleve.

Jemi shpresëplotë se, me përmirësimin e infrastrukturës rrugore të Dukagjinit, zona do të ripopullohet, duke rritë turizmin, do të rritet numri i nxënësve dhe shkollat do të ringjallen nga ana sasiore e cilësore dhe shkollimi do të ketë progres.

Prele Shytani, Shkodër, Mars 2025



Nga e majta në të djathtë, në këmbë janë: Ndokë Leka, Dalina Arra, Martin Arra, Ndoc Odri, Drande Odri, Prele Shytani, Ndue Leka, Marije Gila, Prenda Sogja, Gjon Arrinaj, Tone Meshi, Zef Toka, Dede Kodra, Pashka Shytani, Mhill Qerimi, Gjyste Shyti e Gjeloš Çardaku; ndërsa ukur janë: Mark Gjoni, Pashko Kroniku, Marije Mustaj, Pashko Camaj, Kolë Çardaku e Zef Poti.

Konferencë shkencore kushtuar dy françeskanëve të mëdhenj At' Bernardin Palaj dhe At' Justin Rrota

Fjalë përshëndetëse e Av. Sokol Dedndreaj

I nderuar Fr. Pashko Gojçaj, drejtues i Provincës Françeskane!

I nderuar Arqipeshkëv imzot Giovanni Peragine!

Të nderuar pjesëmarrës në këtë konferencë shkencore kushtuar dy françeskanëve të mëdhenj At' Bernardin Palaj dhe At' Justin Rrota.

Ndjehem i privilegjuar sot, të ndaj me ju një moment dëshmie në nderim të At' Bernardin Palaj O.F.M., meshtar dhe misionar i besimit katolik.

Martirizimi i fretënve të Urdhrit Minor është dëshmi e një besimi të vërtetë. I tillë është dhe martirizimi i të lumit At' Bernardin Palaj, i burgosur në këtë kuvend, i torturuar për dyzet ditë dhe që vdiq në 2 Dhjetor 1946 nga tetanozi i shkaktuar nga teli i hekurt që e shtrëngonte të lidhur në një pemë, pikërisht këtu, në kuvendin e tij.

E kam njohur At' Bernardin Palaj që në fëmijërinë time nga rrëfimet e tim eti, Zef Dodë Dedndreaj, të cilat i mbaj të skalitura në memorien time prej kaq vitesh.

Im atë shkruante në dëshminë e tij:

"Mirënjohje për padër Bernardin Palaj!

Në vitin 1932 në kishën e Palçit kishte ardhur si famulltar, padër Bernardin Palaj. Ishte i ri dhe i hijshëm. Këto cilësi të mira ia hijeshonin trefish edhe zotësia e komunikimit që e bënin një njeri të rrallë. Ai qe jo vetëm një frati i urdhrit françeskan mjaft i devotshëm, por edhe shkrimtar e studiues i përkryer, sidomos për ciklin e legjendave të Mujit e Halilit dhe krejt Eposit Legjendar.

Ai qe bërë mik me babain tim, pasi kishte një horizont të lakmueshëm dhe qe një burrë i mirë i kohës që kishte parë e hequr shumë në jetë.

Unë e njoha atë në shtëpinë time se vinte shpesh për vizita, por edhe për me-

sha ambulante që thoshte në fshat.

Një ditë më mori në kishë dhe filloi të më mësonte abetaren. Kështu fillova të shkoja atje tri herë në javë. Kur u bind se unë mësoja shumë, më qartë, përpjia

të mësojë. Mos u tremb se ke një djalë të vetëm, Zoti e pastë në dorë!

Babai im u bind dhe kështu më nxorën bursën për në Konviktin e Kosovës, në Krume të Hasit. Para se të nisesha, baba



çdo fjalë të tijën, ai i tha tim eti: Duhet t'i nxjerrim një bursë për në shkollë që

më çoi në kishë që t'i lija lamtumirën atij vendi dhe fratit. Padër Bernardini më

bekoi dhe më tha: Qofsh në duart e Zotit bir! Bëhu i urtë dhe i ditur se vetëm kjo është rruga që të çon në përparim.

Unë i jam mirënjohës përjetë padër Bernardin Palajt që më dha këtë drejtim jete". - kështu përfundon dëshmia e tim eti.

Ndërsa Ernest Koliqi do të shkruante në vizitën që i bani famulltarit të Palçit At' Bernardinit:

"Në këtë skutë malesh, ku u përtri për një çast koha më e hovshme e djalërisë që po kalon, po len kujtimin e vet shtegtari Ernest Koliqi, i cili ndejti dy javë në banesën tende, në shtëpinë e mikut të popullit, që është frati shqiptar, ku ndjeva vedin të rrethuem prej një fryme shqiptaro-ilire."

Duke hulumtuar gjejmë në histori sa e sa dëshmi të tilla, që shprehin mirënjohjen për kontributin e vyer dhe gjurmën që la në histori At' Bernardin Palaj.

Në mënyrë të veçantë i gjithë populli i zonës së Nikaj Mërturit, fise të forta e kreshnike, e posaçërisht katundet: Palç, Salcë, Brisë e Curraj Epër, i janë mirënjohës fratit françeskan At' Bernardin Palaj, për zhvillimin e arsimit, për mbledhjen e folklorit dhe ruajtjen e dokumentimit e vlerave kombëtare, për përpjekjet e tij për të ndriçuar mendjet e malsorëve dhe për të zbutur zemrat e tyre fisnike, duke pajtuar gjaqe e duke kultivuar faljen, duke vënë jetën e tij në shërbim të Zotit dhe të njerëzve të këtyre maleve historike.

Kjo konferencë dhe veprimtari të tilla, mbajnë të gjallë kujtimin dhe misionin e At' Bernardin Palaj, përcjellin vlerat kishtarë, humane dhe fisnike të fretënve françeskanë, me shpresën se brezat e rinj, jo vetëm do t'i njohin këta kolosë të besimit dhe njerëzimit, por edhe do të modelohen në shembullin e tyre dhe do të ecin në gjurmët e tyre.

Përshëndes përzemërsisht organizatorët, relatorët dhe pjesëmarrësit e kësaj veprimtarie, duke uruar të përmbushin me sukses misionin, për të përjetësuar kontributin e çmuar të At' Bernardin Palaj dhe At' Justin Rrota në gjuhën shqipe, në folklor dhe histori, në shkencë, në kulturë, në art dhe në çdo dimension njerëzor dhe kishtar.

Shkodër, 8 mars 2025

Përgatiti: Gjon Fierza, mars 2025

Ing. GJON FIERZA

Dita Ndërkombëtare e Pyjeve, 2025

Tema e vitit 2025 "Pyjet dhe ushqimi"

Në vitin 2025, pyjet dhe ushqimet janë tema e ditës, duke vlerësuar rolet vendimtare të pyjeve në sigurinë ushqimore, ushqimin dhe jetesën.

Përveç sigurimit të ushqimit, karburantit, të ardhurave dhe punësimit, pyjet mbështesin pjellorinë e tokës, mbrojnë burimet ujore dhe ofrojnë habitate për biodiversitetin, duke përfshirë pjalmuesit jetik.


Ato janë thelbësore për mbijetesën e komuniteteve të varura nga pyjet, veçanërisht të popujve indigjenë, dhe kontribuojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike duke ruajtur karbonin.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli 21 Marsin Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve në vitin 2012.

Kjo ditë synon dhe rrit ndërgjegjësimin për rëndësinë e të gjitha llojeve të pyjeve. Në çdo Ditë Ndërkombëtare të Pyjeve, vendet inkurajohen të ndërmarrin përpjekje lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për të organizuar aktivitete që përfshijnë pyje dhe drurët pyjor, të tilla si fushatat e mbjelljes së fidanave pyjor.

Pyjet mbulojnë një të tretën e masës tokësore të Tokës, duke kryer funksione jetike në mbarë botën. Rreth 1.6 miliardë njerëz - duke përfshirë më shumë se 2,000 kultura indigjene - varen nga pyjet për jetesën e tyre, ilaçet, karburantet, ushqimin dhe strehimin. Pyjet janë ekosistemet më të larmishme biologjike në tokë, shtëpia e më shumë se 80% e specieve tokësore të kafshëve, bimëve dhe insekteve. Megjithatë, pavarësisht nga të gjitha

këto përfitime të paçmuara ekologjike, ekonomike, sociale dhe shëndetësore, shpyllëzimi global vazhdon. Pyjet kanë nevojë të mbrohen dhe të shtohen.



Kladio Demaj, mjeshtri i pikturës, me penelatat sfiduese, plote drite dhe ngjyra në telajo

Kladio Demaj, është një djalë i qetë, modest, i qeshur e bujar, flet pak, por punon shumë, një krijues i ri, i cili në heshtje dhe imagjinatën e tij, me origjinalitet e pasionin për të bukurën dhe pikturën, plot fantazi, gjetje dhe talent, arrin të nxjerrë nga mendja, duart dhe peneli i tij vepra të arrira në pikturë.

Ky është piktori i ri i talentuar dhe mësuesi i pasionuar i Artit Pamor në shkollat e qytetit të Lezhës "Gjergj Kastrioti" dhe "Besëlidhja": Kladio Demaj, ku me punën e tij si mësues, arrin të zbulojë, të mbështesë e të promovojë në pikturë nxënësit, që premtojnë për t'u bërë piktorët e ardhshëm, duke nxitur tek ata dëshirën, vullnetin, por edhe pasionin për pikturë, duke hapur me ta ekspozita pikturë në nivel shkollash: "Gjergj Kastrioti" dhe "Besëlidhja" në qytetin e Lezhës, në

cilat jep mësim, për festa apo konkurse në nivel shkolle ZVAP dhe DRAP Lezhë, ku nxënësi në shkollën 9-vjeçare "Gjergj Kastrioti" fitoi vendin e parë në pikturë dhe në Jubileun e 581 vjetorit të Besëlidhjes së Lezhës, në të cilën piktori i talentuar, Kladio Demaj, realizoi pikturën morale në korridorin e shkollës "Besëlidhja", Lezhë, me paraqitje mjaft serioze dhe profesionale me përmasa: 11 m x 3 m të Besëlidhjes së Lezhës, Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe princave, me një promovim të kësaj veprë të papare deri tani, duke u nisur nga frymëzimi patriotik të këtij piktori të talentuar, me pjesëmarrjen edhe të mësuesve e të drejtuesve të shkollimit në Lezhë, që e vlerësuan këtë vepër të madhe dhe punën profesionale të piktorit Kladio Demaj. Shoqëruar me portrete, natyrë e qetë, pei-

zazhe, personazhe historikë e atdhetarë, njerëz të thjeshtë të punës e të tjera, i frymëzuar nga aktualiteti, jeta e përditshme, historia, kultura, atdhetarizmi, personazhe të njohur të fushave të ndryshme, me kontribute të ndryshme, etnografia, bukuritë e natyrës, peizazhet natyrore e të tjera, me mbi 100 vepra të arrira në telajo, në akrilik dhe bojë vaji. Një simbiozë e bukur kjo: mësues - piktor, i vlerësuar për punimet e tij të arrira, që shumë janë nëpër shtëpi, lokale, institucione, ambiente shkollore e të tjera, ku mbizotëron simetria, koloriti, shumëllojshmëria e ngjyrave, ndriçueshmëria e figurave, një piktor, që i flet puna dhe veprat, i vlerësuar me çertifikata dhe çmime të ndryshme edhe duke u përfaqësuar denjësisht si një nga artistët e rinj të përzgjedhur në një nga Programet "Krijimi i Veprave

Multifunkionale për Muze" 2022, direkt, duke fituar çmimin e parë, duke treguar kështu pjekuri artistike, stilistike dhe profesionale.

Piktori i pasionuar dhe mësuesi i përkushtuar, Kladio Demaj, vijon të ushtrojë profesionin e tij, në detyrën e mësuesit dhe si piktor i suksesshëm, me angazhim, vullnet, pasion dhe profesionalizëm edhe në punën me nxënësit dhe në detyrën e mësuesit të Artit Pamor, duke përgatitur nxënësit - talente të reja në pikturë, të cilët do të jene e ardhmja, por edhe duke nxjerrë nga mendja, dora dhe peneli i tij piktura të arrira, me penelata në telajo plot ngjyra dhe dritë, duke u preferuar nga dashamirësit e këtij arti.

JAK RROZHANI
gazetar në Lezhë



Traditë dhe histori - Pranvera

Sot, që po shkruaj jemi në Pranverë, në muajin mars, kur fillon Pranvera dhe si shkak për këtë shkrim u bë data 14 mars, gjoja dita e Verës. Kjo traditë vjen nga koha e paganizmit dhe vijon edhe sot.

Une nuk e di nga ka ardhur dhe kush e feston këtë datë, që sipas tyre simbolizon ditën e Verës, megjithëse nuk dua ta di, se historinë nuk mund ta ndryshojmë. Por një gjë, është e sigurt dhe e vërtetë shkencërisht dhe botërisht se, Vera nuk vjen kurrë para Pranverës, sepse viti ka katër stinë e veta: Pranvera, Vera, Vjesh-ta dhe Dimri. Atëherë, që në fillim është vendos radha e stinëve gabim, sepse e para duhet Pranvera.

Tani të po ecim nga titulli "Traditë dhe histori" ... Pranvera çfarë është dhe çfarë përfaqëson, në trojet tona? Simbas traditës tone, Pranvera, është me datat 21 e 22 dhe 23 mars dhe e kujtojmë çdo here.

Kjo ka edhe një domethënie shkencore, sepse me 22 mars ndoll edhe solcidi pranveror, që dita dhe nata barazohen me nga

12 ore secila. Pra, në këtë datë ka mijëra vjet që është i njohur ky fenomen. Pra, ky festim nuk ka të bëjë me asnjë besëtytni, por me fakte natyrore e ruajtur dhe e trashëguar qindra breza me radhe, në trojet tona.

Në malet tona këto data janë festuar,



se përfaqësonin ditët e Pranverës, duke e shoqëruar me mbjellje të ndonjë peme apo bime bujqësore pavarësisht se car dite ishte, me shi apo me diell, duhej patjetër të mbjellje diçka, nuk duhej therur me gjilpërë, nuk duhej dhanë as marr hua. Çdo njeri, duhej lare dhe vesh diçka të re, për këta ditë e të tjera.

Me këtë rast, ka edhe një fenomen tjetër, i cili është i njohur nga të gjithë. Me

datën 25 mars fillojnë pleq e plaka, dy javë plakat dhe dy javë pleqtë. Kjo periudhë pleqsh përfundon me datë 22 prill, natën e Shëngjergjit, që themi se tani duhet Vera.

Po, edhe ne e kemi festua ditën e Verës, por e kemi festua, me datën 6 maj dhe i kemi thanë Shëngjergji i mbram, i cili festohet dy javë mbas Shëngjergjit të Pranverës, me datën 22 Prill. Kjo datë festohet nga të gjitha vendet e lindjes deri në Rusi.

Për Shëngjergj të mbram, është kenë traditë, me lëshua bagëtinë për mëngjes, që do të thotë me lëshua herët dhitë, me edha apo dhentë me qengja dhe me i kthye me i mruzua te shpija apo te stani apo ku kanë ndoll në atë kohë.

Këtë traditë e dinë e gjithë mosha e trete dhe ata që kanë jetuar në fshat dhe janë marr me bagëti. Ndaj këto ngjarje janë edhe tradita, por edhe ngjarje që kanë lidhje me natyrën. Është humbje e madhe mos kujtimi i këtyre traditave dhe vlerave, sepse ne po humbim identitetin tonë kombëtar.

GJON KOSTERI

Krimi në familje, vijon të marrë çdo ditë jete njerëzish



FRAN GJOKA

Familja shqiptare po kalon një nga situatat më të vështira në historinë e ekzistencës së saj. Janë shumë faktorë ekonomikë e historikë, kulturorë e psikologjikë që po kushtëzojnë këtë situatë të lëkundur të shëndetit social të familjes, kësaj vatre të ngrohtë, e cila ka pësuar shumë ndryshime e transformime gjatë gjithë periudhës së tranzicionit dhe të kalimit nga modeli strukturor tradicional në atë modern.

Çfarë po ndodh në familjen shqiptare?

Brenda familjes po shfaqen shumë fenomene negative, që po tërheqin vëmendjen e opinionit të gjerë shoqëror. Një nga plagët sociale që po shfaqet dhe që evidentohet edhe statistikisht, por dhe nga pikëpamja empirike është zgjerimi i dhunës dhe krimit brenda familjes, e cila e ka vënë qytetarin shqiptar përballë dilemës: A mund të jetohet normalisht në një "shoqëri të kriminalizuar", në të cilën krimi është bërë gati si "buka e përditshme"? Pse familja është bërë kaq e dhunshme dhe me sasi të larta të krimit brenda saj? Familje apo çmendinë? Kur përpiqemi e përkushtohemi të bëjmë jetë të qetë sociale, shoqëria po mbushet me të "çmendur", duke marrë trajtën dhe formën e një spitali psikiatrik? Pse kaq shumë njerëz në shoqërinë tonë vriten, humbin jetën për motive banale dhe gjëra të rëndomta e pa vlerë? Këto janë pyetje, që i lindin çdo qytetari që jeton në këtë shoqëri, përballë me dhunën dhe krimin e përhapur kudo, në familje, shkollë, mjedise sociale e vende publike. Sasia e zgjeruar e vrasjeve dhe krimit në familje e jashtë saj, janë kaq të zgjeruara e intensive, sa që në mënyrë intuitive të duket sikur jemi në një shoqëri, në të cilën krimi dhe vdekja janë bërë si të ishin "nevoja natyrale" e shoqërisë. Analiza sociologjike e ontologjisë dhe fenomenologjisë së krimit në shoqërinë tonë, tregon për një prirje shumë delikate që ka lidhje me një lloj "strukturimi homogjen", midis fenomenit antisocial të krimit dhe veprimtimit të kriminelëve, të cilët kanë tendencën e thellimit të sjelljes kriminale, duke u shfaqur si "qenie të degraduara", të cilët nuk kanë kurrfarësi human, nga që kanë nxjerrë "jashtë përdorimit" dialogun, komunikimin, humanitetin apo tolerancën. Kjo është arsyeja pse duket qartë që në disa drejtime, shoqëria jonë

ka marrë karakteristika të dhunshme, që shfaqet shpesh si krizë sociale me defekte serioze në mënyrat e komunikimit social dhe personal. Kjo e bashkuar me një proces të përshpejtuar të dehumanizimit dhe desolidarizimit të lidhjeve njerëzore, janë arsye të zgjerimit të konflikteve, dhunës, krimit.

Qëndrimet simpliste ndaj krimit, veçse e konstatojnë, por nuk e zgjidhin situatën

Në qëndrimin ndaj krimit dhe gjykimin e merituar ligjor të kriminelëve, shpesh herë ndeshemi me analiza simpliste të shkaqeve, shoqëruar me argumentime ngushëlluese e moralizuese të atyre që i kanë kryer ato, duke zbutur fajin dhe përgjegjësinë penale të kriminelëve, nën arsyetimin ngushëllues të "ekzistencës së përjetshme" të së keqes, krimit në shoqërinë njerëzore, faktit që vrasjet kanë qenë pjesë përbërëse e jetës. Këto qëndrime, qoftë edhe në trajtë latente janë tejet të rrezikshme, të papranueshme. Në se justifikojmë krimin dhe kriminelët me



argumentin banal të "ekzistencës së përjetshme" të së keqes dhe vazhdimësisë së vrasjes në shoqëri, "...kështu vëmë veten në rrezik; dhe rrezikojmë në radhë të parë njerëzoren te ne, e cila në thelb është pjesa jo kafshërore, aspekti etik i vetes". (Z. Bauman, "Moderniteti dhe Holokausti", f. 314).

Kjo plagë sociale po merr përmasa të mëdha dhe është duke u agravuar ditë ditë në krahina të ndryshme të vendit. Është fakt i pamohueshëm, se thuhet çdo ditë media pasqyron në rubrikat e informacionit raste të krimit në familje dhe në gjini. Grindje, dhunë, abuzim seksual, vrasje, vetëvrasje, mbushin faqet e shtypit dhe programet e lajmeve. Ky fakt është një nga dukuritë shqetësuese që shfaqet në ditët e sotme, me një shpërndarje gjeografike pothuajse gjithëshqiptare. Ndërkaq ka treva dhe zona të veçanta, ku çdo tre ditë shënohet një i vdekur nga shkaqe të ndryshme, sidomos nga hedhjet nga ndërtesat dhe nga vetëhelmimet, që tashmë janë bërë të zakonshme, apo duke përdorur mjete dhe rrugë të tjera disi barbare për t'i dhënë fund jetës. Ndërsa dhu-

na, kryesisht ndaj femrave dhe fëmijëve, është aq e shpeshtë, sa të krijohet përshtypja se jetojmë në një shoqëri tërësisht të karakterit primitiv.

Krimi dhe kriminelët shtohen si barërat e këqija

Krimi në familje është zgjeruar në formë dhe përmbajtje, duke u bërë një dukuri sociale shumë shqetësuese. Akoma dhe më të shëmtuara janë rastet kur krimi në familje merr karakter gjinor, kur babai vret djalin dhe anasjelltas, vëllai motrën, burri gruan. Ngjarje të tilla ndodhin shpesh herë nga gjaknxehtësia, apo nga përplasje e kornizave kulturore e morale midis brezave. Ato po bëhen aq të shpeshta në realitetin shqiptar, sa që shoqëria, politika, opinionin, shteti dhe institucionet e tjera sikur kanë krijuar imunitet dhe janë ambientuar me to. Ambientimi me këtë nivel absurd të krimit në familje duhet të përbëjë shqetësim për shtetin, shoqërinë, politikën, median, shkollën, institucionet fetare, komunitetin etj. Nuk qarkullon kot mendimi të qytetarët, sipas

e këtij fenomeni makabër, duan të dine pse - të, jo thjesht për kuriozitet, por për të marrë masa parandaluese ndaj këtyre fenomeneve absurde. Është momenti kur duhen përcaktuar diagnoza të përgjithshme të situatës dhe shkaqeve të krimit në shoqëri dhe veçanërisht të shkaqeve të dhunës në familje. Njëherësh duhen përcaktuar edhe rrugët se çfarë duhet bërë, për të parandaluar këto situata të pakëndshme. Së paku duhet të zgjerohet angazhimi social, sepse ne kemi mundësi për të ndikuar në zbutjen e tij. Në pamundësi për t'a parandaluar dukurinë, ajo që kërkohet minimalisht është ngritja e këtyre problemeve në rang shtetëror dhe strukturat e tij, apo mbi institucionet e edukimit dhe të arsimimit, si kusht për përmirësimin e situatës së parandalimit të krimit në familje e shoqëri.

Shteti, familja, shkolla dhe shoqëria nuk duhet të jenë spektatorë

Shkaqet e krimit që jep media janë thjeshtë një përpjekje për të gjetur arsye të paarsyeshme, pse jo të stimulojë edhe një treg komercial të shtypit tonë. Kjo ndodh sepse çrregullimet e personalitetit, gjendjet depresive tek njerëzit dhe sjelljet devijante në tërësi nuk krijohen menjëherë, sepse "budallenjtë", me përjashtime të rralla, nuk lindin të tillë, por formohen gjatë periudhave të jetës, se pijanecët kronikë e kanë një "hall" që shkrehen shumë pas alkoolit, se adoleshentja ose studentja që hidhet nga lartësitë, e ka një shqetësim të akumuluar prej kohësh, se skenarin e vetëhelmimit, vetëvarjes dhe vetëvrasjes, siç ndodh në tërësi për çdo rast të tillë, duke përfshirë edhe vrasjet brenda familjes, aktorët dhe autorët e përgatisin me kohë dhe presin një ditë të përshtatshme për realizimin e tij. Ndërsa institucionet, shteti, shkolla, komuniteti dhe familja e struktura të tjera jo qeveritare pas aktit makabër shprehin habinë dhe pse jo sajojnë dyshime nga më të ndryshmet, madje krijojnë alibi nga më të çuditshmet për ngjarjet. Përtej këtyre "motiveve" vrastare, tejet tronditëse dhe shkatërruese për familjen e sotme shqiptare vijojnë shkaqe, motive dhe qindra arsye të tjera me natyrë sociale, psikologjike, ekonomike dhe kulturore, që duan analiza dhe përfundime të sakta, që studiuesit e të gjitha fushave, gazetarët e opinionistët, analistët dhe krijuesit duhet të merren me to dhe t'i japin rekomandime kompetente shoqërisë dhe shtetit e pse jo të bëjnë edhe oponentë të fortë, me dëshirën e mirë që ky fenomen rrëqethës të zbutet dhe shkalë - shkallë edhe të kapërcehet. Pa pretenduar se problemit do t'i shkohet deri në fund, po cek vetëm disa prej shkaqeve që e ngacmojnë mendimin qytetar dhe atë intelektual, i cili është i ndjeshëm ndaj fenomenit dhe që mund të ndikojë mjaftueshmërisht në përmirësimin e situatës.

të cilëve në Shqipëri tashmë asgjë nuk na bën përshtypje. Shkurt: kronikat e zeza na kanë lodhur, na kanë stresuar dhe po denigrojnë personalitetin e shoqërisë sonë. E turpshme për ne që vazhdojmë të jetojmë me shpresën se pas reflektimit diçka do të korrigjohet, se politikëbërësit do t'i vënë gishtin kokës për ta shëruar disi këtë plagë të shëmtuar të shoqërisë dhe me kosto të lartë për jetën. Pas rasteve të përditshme, që transmetohen me aq zell në median elektronike dhe të shkruar, vijon edhe "shkaqet", edhe "motivet", shpesh edhe banale: "Ishte në gjendje të rëndë depresive, i sëmurë psikik, i dehur...". Janë të rralla rastet, kur bëhen përpjekje për të dalë përtej këtyre "argumenteve" absurde, që nuk bindin askënd.

Të merresh me pozimin e problemit, me informimin e publikut, është njëra anë, por është një prej detyrave funksionale të medias elektronike, vizive dhe të shkruar, por kjo nuk është e gjitha. Shoqëria në tërësi dhe qytetarët në veçanti duan të dalin përtej konstatimeve absurde, duan analiza të thella dhe konkluzione konkrete, duan të njihen me shkaqet

Në kujtesë, Martin Camaj në 100 vjetorin e lindjes dhe 33 vjetorin e ndarjes nga jeta

MARTIN CAMAJ, LINDI NË TELUMË TË TEMALIT ME DATE, 21 KORRIK 1925.

U NDA NGA JETA, ME 12 MARS 1992, LENGGRIES, MÜNCHEN GJERMANI.

Të dashun miq e vëllazën shqiptarë, intelektualë, artistë dhe mbarë populli shqiptar, përshëndetjet e mija ju janë drejtue të gjithëve.

Gëzohem pa masë se keni vendosur të vlerësoni veprën time: Ky vlerësim na afron. Bâtë burrninë të më shtini në rreshtin tuej. Ndonëse të ndamë për një gjysmë shekulli, unë jam i jueji e ju jeni të mijt.

Martin Camaj, 7 Mars 1992.

Në verën e vitit 1992, pak kohë pasi Martin Camaj kishte ndërruar jetë, në Temal të Dukagjinit erdhi vetë Erika, bashkëshortja gjermane e poetit. Ajo erdhi për t'u njohur me vellezërit dhe fisin e bashkëshortit tashmë të ndjerë. Erika, në mes bisedave të tjera, përemendi edhe një amanet të Martinit të lënë kur qe i gjallë. Ajo u kërkoi të afërmeve të shoqit një rrasë guri të Telumës së Temalit. "E dua një rrasë të katundit të Martinit me ia vënë te kryet e varrit të tij në Gjermani, si rrasë varri. Ma ka lënë amanet pak para vdekjes im shoq, se kështu e kishit pasë tradite në këto male, më ka thënë Martini".

GURI I MARTINIT (Martin Camaj)

*Mik i gjakut të penës, kush e di sa vite
Fëmijë të kërkoja me "Një fyell ndër male"
Kush e di se në male, përmbi gurë më rrite
Me një daltë fjale
Dhe sot pas sa vitesh që s'na panë
Më del në Bavari me një gur prej Dukagjinit
Rritur me qumësht ashti të tokës nënë
Jam guri i Martinit
Më lër edhe pakëz, më lër, Gur i Martinit
T'ia mbaj dorën në krah si andej në Malësi
T'ia ftoh shkrumët e ballit e të mërgimit
Dhe do shkoj, s'do rri
Pse gurët dhe poetët nëpër botë
I dashka të shpërndarë ky dhe i yni
Zi nuk mbajmë, po kurrë mos qofshë e kotë
Dhembje në Gur Martini.*

Azem Shkreli

Martin Camaj është një nga shkrimtarët më të mirë të kombit shqiptar, me po atë vlerë në prozë sikurse në poezi, dy hapësira të mëdha, me të cilat ai u përpoq të zëvendësonte atdheun e munguar. Ishte po aq i fisëm në veprën e tij, sa edhe në vizionin për raportet njerëzore brenda familjes së shkrimtarëve. Këto të fundit, për fat të keq, vazhdojnë të jenë kaq munguese në jetën tonë."

Ndjesia e pare, që provon lexuesi kur hyn në botën letrare të Martin Camajt, është ajo e lartësisë. Lartësitë e bjeshkëve, më saktë Dukagjini, ku ai kishte lindur, kishin gjetur, më në fund, te biri i tyre, mjetin e vet shprehës.

Ismail Kadare

DISA POEZI TË ZGJEDHURA
NGA KRIJIMTARIA E MARTIN CAMAJ

Vendit tim

*Kur të vdes, le të bahem bar
Në malet e mia në pranverë
Në vjeshte do të bahem farë.*

*Kur të vdes, le të bahem ujë
E fryma eme avull
Në fush do të bie shi.*

*Kur të vdes, le të bahem gur
Në skajin e vendit tim
Të qindroj kufi.*

Vajzë me faculetë në krye
*Vajzë me faculetë në krye,
së din askush si ballin e ke të gjanë
e vetullat e holla.
Vajzë me faculetë në krye,
flokët tu, vetëm, e dinë shtypjen
e barit të njomë prej borës
e peshën e dëshireve të pashfryeme
të brëznive të pështjelluna në mote t'verdha.*

Dy gjana print m'thanë kur ishin gjallë
*Dy gjana print m'thanë kur ishin gjallë:
Po qe se shkel ti bukën gand,
Çoje prej dheut, puthe e vene në ballë!
Ndëgjò, ti djal, pse na jemi pleq.
Kur t'rrijsht te votra mbështetë tue pí duhan,*

*Mos pështyj në zjarm,
Mos pështyj në dritë, pse â keq!
Kam harrue shum sende që m'i thanë print
shum tjera m'sova e dola ndoshta i larm;
por bijve të mij un kam me u thanë tu' rritë:
Mos shkelni bukën,
Mos pështyni në zjarm,
Mos pështyni në dritë.*

Tregimi i arbnit

*Më thà një arbën vllaznisht, pa më njohtë:
"Gurt, eshtnat e dheut, kudò i kam kapë
Ndër duer e m'lanë përshtypje të ftohtë
Si prekja e gjarpnit kulaç në vapë,
Por guri i caranit n'votër tim èt
Qe prore i nxetë.
Rrasat, si akull në brijat e malit
M'u duken tue i vrejtë dikur kundruell
E fëtyra e tyne si trajta e kalit
T'egër tue u shkarravendë nëpër truell,
Por rrasa nën kambë në votër tim èt
Qe prore e nxetë."*



100 vjetori - 2 Mars 1925 - i vrasjes së Luigj Gurakuqit

(nga shkrimet, e një bashkohësi të tij)

Atë ditë, 2 Marsi ishte e hane, ndërsa sot, 100 vjet pas, - 2 Mars 2025 - e djelë ditë pushimi.

Në Shkodër, vendlindja e Gurakuqit, u mjaftua me vendosjen e disa kunorave nga Prefektura dhe disa veteranë të luftës, banda e Bashkisë, televizorët lokal dhe asgja më shumë.

100 vjetori, si i lindjes, poashtu edhe i vdekjes, së çdo njeriu, edhe familjar, përbën një ngjarje e rëndësishme, e aq më shumë për figura të ndritura të historisë së një kombi, si i yni. Nejse, kjo kaloi!

Po sot, në Lezhë, ndonse nuk qe një datë që shënjon përkujtimin e Besëlidhjes së Lezhës në përvjetorë simbolik - ishte 581 vjetori - por, vendosja e një Shtator-eje të Gjergj Kastriotit, në përkujtim të kësaj ngjarje, mori vemendje të merituar, edhe me pjesmarrjen e vetëm, të Presidentes së Kosovës, znj. Vjollca Osmani dhe disa ministrave të qeverisë sonë, dhe e Kryebashkiakut të Lezhës.

Në Shkodër, javën që shkoj, në Muzeun e Qytetit, u ringritë një pavion në nder të Luigj Gurakuqit, them, një pavion se, dikur kishim një "Shtëpi Muze" të Luigj Gurakuqit, shumë të pajisur me artefakte, dokumentacion, madje, edhe me rrobat që pat veshur atë ditë të hane të 2 Marsit 1925 Luigji i mjerë, i shoqëruar edhe me miq e shokë, sapo kishte mbërritur në Bari, e vrau dora e shtyrë nga kundërshtari i tij politik, Zogu i Parë, e dorasi qe një kushëri i tij, Baltazar Stamolla, ashtu siç e ka "damkos" historia.

Që nga viti i kaluar, ne kemi në duar një libër shumë të vlefshëm, shkruar nga Gjon Kamsi "Njerëz dhe ngjarje të lirisë së Shqipërisë" - Rradhontë e Shëjzave, Botimet Shkodra.

- Gjon Kamsi (1894-1992) ekonomist i naltë, ka qenë mik dhe bashkëpunëtor i Luigj Gurakuqit, At Gjergj Fishtës, Hasan Prishtinës, Sotir Gjickës, Mustafa Krullës, Bahri Omari e shumë personaliteteve tjera. Veprimtaria e tij asht zhvillue kryesisht në gjysmën e parë të shekullit XX në Shkodër. Në Tiranë dhe Bari të Italisë, ku botoi në vitin 1940 vëllimin me poezi

"Vjersha" të Luigj Gurakuqit.

Burrë me karakter të papërkulun dhe me ndjeshmëni të rrallë qytetare, botoi shumë artikuj dhe studime por la mjaft dorëshkrime, që sot përbajnë një dëshmi të historisë së qytetit të lindjes dhe të vepërimit patriotik nga koha e Pamvarsisë deri në fund të jetës së tij. - (Në kopertinën



e mbrame të librit, gjenden këto shënime).

Shënime nga libri:

"Me 2 mars 1925 vritet Luigj Gurakuqi. N'atë kohë (Gj. Kamsi) banonte në Bari (Itali), merr pjesë në vorrimin e tij, ruen kujtimet e tija me gjithë petkat e përgjakuna. Me 18 fruer 1964, tue pá se u kthye në muzë shtëpia e Luigj Gurakuqit, e pau të arsyeshme që reliket e tija. Petkat e përgjakuna e të tjera, të ishin në atë shtëpi, dhe ia dhuron Muzeut".

I kushton një kujdes të posaçëm vorrit të Luigj Gurakuqit, tue vù aty një gur të skalitun, të marrun në Trani, qytet ku gjykata vendosi jo dënimin, por faljen e vrasësit, si dhe një mbishkrim që sot gjindet në Muzeun historik të Shkodrës e tue e mirëmbajtë qysh prej vjetit 1925 deri në 1943 kur edhe krejt familja kthehet në Shqipëri. [Ai mbishkrim kaloi aty kur u mbyll Shtëpia - Muze prej blesit të saj që e kishte marrë në pronësi nga mbesa e padëjë e Luigj Gurakuqit. Fill mbasi ndodhi që u shemb kjo shtëpi me dashje nga

blesi dhe nga përçmimi i fajshëm i atyne që duhej ta ruejshin (n'atë kohë ministrat e "kulturës" Edi Rama dhe Arta Dade) megjithëse ishin njoftuem me shkrim. Kështu ndodhi që Luigj Gurakuqi të vritej për të tretën herë, tue pasë qenë për të dytën herë me vendimin e turpshëm të gjyqit të Tranit]."

"Shenimet, nga Prof. Willy Kamsi - djali i Gjon Kamsit. (fq. 424-427)".

Shkodra, gjithësesi, Luigj Gurakuqin e ka birin e vet ma të shtrejtë, Universiteti i Shkodrës mban emnin e tij, Gjuhadori, rrugës ku kishte shtëpinë e tij atnore, e pagëzoi me emnin e tij, në Qendër të Shkodrës, qëndron si Vigan Liberator, një Statujë e bukur krejt shkodrane, ndonse Sheshi mban emër tjetër, çka nuk do të ishte ashtu, Luigji ishte aty, askund nuk ndodh që në një Shesh kund disa metra katror, të vendosësh dy Shtatore emërmëdhenj, por, kështu jemi ne, kriteret "shkelen" me asgjë!

Paradokse shqiptare!

Historiografia jonë "komuniste" asht e mbushun me "dokrra hini".

Për Luigj Gurakuqin, janë shumë autor që janë përpjekur të shkruajnë biografinë e tij, por ai që nuk duhet t'ia lejonte vehtës ashtë, Pirro Tako, ndonse, koha nuk ja lejonte, por sidoqoftë, mendoj se, me pak

"diplomaci" mund të ishte shmangë nga paragrafët e mëposhtme!!

"Vështirësitë që i dalin një autori në këto udhëkryqe të historisë janë të shumta, veçanarisht kur është fjala për Luigj Gurakuqin. Materialet e Partisë dhe Veprat e shokut Enver Hoxha janë një burim i pazëvendësueshëm për kapërcimin e tyre. Veçanarisht shoku Enver Hoxha e ka çmuar dhe vlerësuar në shkallën më të lartë kontributin që ka dhënë L. Gurakuqi si patriot i flakët dhe statist i shquar.", fq. 6.

Luigj Gurakuqi bën pjesë në atë grup luftëtarësh e patriotësh të shquar, që siç e ka vënë në dukje shoku Enver Hoxha "ishin shkëputur nga klasa e tyre dhe nga qëllimet e idealet skllavëruese të klasës së tyre".(Vepra, vëll.16, fq. 427).

Figura të tilla të shquara, si L. Gurakuqi i ngriti në pidestalin e pavdeksësisë koha e jonë e madhe heroike, epoka e Partisë, epoka e socializmit. fq. 412."

Gurakuqi në jetë pati edhe ndonjë gabim. "I mençur, - shkruante Vladimir Iliç Lenini, - nuk është ai që nuk bën gabime. Njerëz të tillë s'ka dhe s'mund të ketë" (Sëmundja foshnjore e "majtizmit" në komunizëm",fq. 23-24).

Fjalët e fundit

Lidhur me librat për Luigj Gurakuqit, shkonin te P. Justin Rrota - frati ynë i ditur dhe i lexuar si ai, gjuhëtar, shkrimtar dhe profesor i Liceut Françeskan - edhe personalitet të kohës që i kerkonin ndihmë në libra, njeri nga ato, tregohet në EPISTULAR-in e Prof. Jup Kastrati - P.Justin Rrota O.F.M, një shkodran i Tiranës, sesi, kerkon ndihmë, por, ç'heq i shkreti Padër, me marrë librin e tij.

Ishte koha, kur merr libra thelbësor, e përpunoji sipas mësimëve të shokut Enver, siç është rasti i mësipërm, i treguar këtu më nalt.

Por kjo, herën tjetër!

Fund, Shkoder me, 2 mars2025.

Leonard Qyteza, Shkodër me, 2 mars 2025

Pensionistet, shtresa ma vulnerabël

NDUE ZIÇI

Njerëzit sa të kalojnë të 50 - tatë në jetën e tyre, mendojnë për vitet e pensionit. Qëllimi i vetëm është se, si ta mbyllim pleqërinë pa problem ekonomike. Të përballojmë vitet e mbetura pa skamje e varfëri. Në këtë drejtim duhet të mendojë shteti, i cili i ka punësuar e vijimisht u ka mbajtur kontributet, por Shteti i ka lënë në harresë.

Ka mbi 30 vite, që flitet për rritjen e

pensioneve, madje me këto pensione e pensionistë është bërë politike, dhe kulmim e saj arrin sidomos një here në dy vjet, vite zgjedhore. Pikërisht, kur hapet qesja, me fjalë e lëmoshe e quajtur bonos. E sanksionuar për festat e fund vitit. Në buxhetin e shtetit për vitin 2025, nuk u fol fare për zërin e rritjes së pensioneve. Këta ligjvënës a jetojnë me situatën? A e dinë se, sa janë pensionet në Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Mal të Zi e të tjera? Sa propagandë do ishte bërë, sikur pensionet të ishin më të lartat në rajon? Duke

trumbetuar me të madhe, se ne jemi Qeveri sociale, mendojmë për shtresat në nevojë, japim gjithçka nga vetja! Zakonisht krahasimet në rritjen e pensioneve i bëjnë me vitin 2013, ndërsa çmimet e asaj periudhe nuk i zënë me gojë, të cilat janë trefishuar. Po kjo nuk mund të ndodhin se për vete ata i kanë dyfishuar pagat e tyre. Sot një deputet merr para sa 30 pensioniste. Për vitin 2025, Qeveria paska menduar për një bonos tjetër në pranverë.

(vijon në faqen 14)



Dramaturgjia Shkodrane - Krenaria e Dramaturgjisë Kombëtare

Gjini letrare, që përfshin një tekst të shkruar në formë dialogu, i përcaktuar për teatër.

Njohu rilindjen e vet së bashku me teatrin, në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Shkodra është qyteti i parë në Shqipëri që e zhvilloi këtë gjini arti me anë të shkrimtarëve të saj, që jo vetëm shkruan drama me tema shqiptare, por që përpunuan, përshtatën dhe sollën në shqip, shumë drama dhe komedi të huaja. Përveç kësaj Shkodra do të ishte në qytetet e para që i vuri ato në skenë, me regjisorët dhe aktorët e saj diletantë dhe më vonë me profesionistë. Kaq shumë drama, melodrama, bocete, komedi janë shkruar, natyrisht dhe përkthyer dhe përshtatur në Shkodër, por që janë vënë në skenë nga grupe amatore të përbërë nga zanatçij të të gjithë mjeshtrive, nga nxënës të shkollave jezuite dhe françeskanë, shumë shoqëri të krijuara në Shkodër, sa të bënë të mendosh thellë çfarë jete kulturore të larmishme paska pasur Shkodra. Një jetë e vërtetë kulturore që megjithëse njerëzit nuk e kishin modernitetin e sotëm, por që të ban të mendosh për shpirtin e thellë artistik të shkodranit, që e ka dashur gjithmonë teatrin, komedinë, muziken dhe çdo gjë qejfi, që ja ka ba jeten aq të larmishme e të gëzueshme dhe kur? Kur ato në xhepat e tyre kishin lekë shumë ma pak se kanë sot, kur merrnin pjesë si amatorë pa asnjë shpërblim, por që kishin shpirtin e madh të demonstronin artin e tyre artistik. Vetëm të lexosh librin e Andrea Skanjetit "100 vjet teatër në Shkodër 1879 - 1979", botuar në Shkodër në v. 2000, ku unë i jam referuar në disa studime, atëherë ke për të kuptuar këtë jetë artistike të qytetit tonë të dashur

Nga shumë studiues konsiderohet e dokumentuar si shfaqja e parë teatrale në Shkodër, ajo e 20 shkurtit 1879 nga nxënësit e shkollës Saveriane, që shfaqen farsën "Mako" të J. Çezarit, përkthyer shqip dhe përshtatur traditave shqiptare. Arbëreshi Leonardo De Martino, botoi në Shkodër më 1880 një tekst me karakter liturgjik "Nata e këshëndellave", dramë që i kushtohet lindjes së Krishtit, shkruar për fëmijët e Shkodrës dhe e vënë në skenë nga ata në Kishën e Minoritit, me rastin e Krishtlindjeve (1880). Më 1882 u dha komedia "Biri i çifutit", përshtatur në shqip nga dom Pashk Babi. Regjisori dhe studiuesi Lec Shllaku në librin e tij "Maska shkodrane - Kur lindej teatri", shkruan se shfaqja e parë në qytetin e Shkodrës daton në vitin 1876, me pjesën "Zefi i humbur". Janë me dhjetra drama, melodrama, komedi të përkthyer dhe të vëna në skenë nga grupet amatore, nga shumë intelektualë patriotë, poliglotë, që në mënyrë të detajuar jepen në librin e Andrea Skanjetit. Të tjerë intelektualë, shkrimtarë u vunë në shkrimin e shumë dramave me karakter kombëtar, patriotik. Kështu Anton Xanoni, shkruan dramën "Skënderbeu", e cila u vë në skenë 24. 02. 1914. Po kështu një dramë e përkthyer nga frëngjishtja nga Gjon Bazhdari vihet në skenë më 27.

11. 1914. Drama me pesë akte "Vdekja e Skënderbeut", shkruar nga Helenau (Kolë Mirdita) shfaqet me sukses në vitin 1916. Po kështu drama me pesë akte "Moisi Golemi" shkruar nga Anton Xanoni vihet në skenë më 1917. "Ora e Shqypnisë" bocet dramatik u shfaq më 1920 nga nxënësit e Kolegjit Saverian, "Shpata e Skënderbeut" ose "Ballaban Pasha", dramë me tre akte shkruar nga Anton Xanoni, ku dënohet trathëtia e Moisi Golemit, vihet në skenë nga aktorë të ndryshëm. "Konti i Drishtit", shkruar nga Kolë Dema, dramë historike me 5 akte jepet nga nxënësit e Kolegjit saverian, më 1930, e të tjera e të tjera.

Ngritja e shoqërive kulturore - artistike "Bogdani", "Rozafat", "Vllaznia" e të tjera, kushtëzoi shkurrujen, përshtatjen (nga ato të huajat) e shumë dramave, si nevojë për t'i vënë ato në skenë. Shumë prej shfaqjeve ishin komedi, të përkthyer, por nuk mungonin dramet me karakter kombëtar patriotik. Drama e Zef Harapit "Oso Kuka" me pesë akte e u shfaq me 14. 09. 1942, në oborrin e shoqërisë Antoniane dhe dy herë në kinema "Kosova" në Tiranë.. Po nga kjo shoqëri vihet në skenë drama "Gjin Bue Shpata" shkruar nga Filip Fishta. Shoqëria "Rozafat", me rastin e 25 vjetorit të pavarësisë shfaq dramën "Kthimi i Skënderbeut në Krujë" e punuar sipas dramës "Përpjekjet për liri të Skënderbeut" dhe të hymnit të tij në Krujë. Shoqëria "Bogdani" vë në skenë melodramën patriotike "Ora e Shqipnisë", e të tjera.

Një dramaturg pak i njohur ishte edhe Asim Lohja, që shkroi dramën "Për mrojtje të Ulqinit" ku ka treguar përpjekjet e vullnetarëve shqiptarë në mbrojtje të Ulqinit. Drama "Për mprotje të Ulqinit", është shkruar në shkurt të vitit 1943, nga studenti Asim Lohja. a grupi teatror i "Komunitetit Mysliman" i kryesuar nga Zenel Broja. U shfaq edhe në Teatrin e Tiranës. Në familjen Lohja ruhen dorëshkrimet origjinale të disa dramave të tjera sqërhoore, si drama "Vada", "Kunorë dhe gjak", e të tjera

Ndër dramaturgët e shquar të periudhës 1912-1924, At' Gjergj Fishta shkroi 8 drama, në trajtën e poemave dramatike, me kuptime filozofike, të ardhura nga ngjarjet biblike, mitet dhe folklori, si "Juda". Drama u shfaq në sallonin e "Teatrit të Parrucës" dhe në Kinema "Rozafat" në fillim të v. 1938, nga "Makabe", "Odisea", "Ifegjenia n' Aulli", "Shqyptari i gjytetnuen", "Shën Françesku i Azisit" e të tjera. Komedia e tij "Gomari i baba Tasit" do të ishte një nga krijimet më të fuqishme satirike të letërsisë së kohës, kurse tek "Jerina, mbretëresha luleve" binte në sy lirizmi

dhe poezia.

Ernest Koliqi me tri dramet e tij "Kushtrimi i Skënderbeut", "Takimi i orës 9 të mbramjes" dhe "Rranjët lëvizin", bëhet pararendës i dramës së re.

Zef Mark Harapi ka shkruar një sërë veprash dramaturgjike me temë patriotike, si "Oso Kuka", (1921), "Mustafa Pasha i Shkodrës", (1923), "Flamuri i Shqipërisë do të mbretënojë", "Ded Gjo Luli"(1938), si dhe dramën e fundit "Tringa e bajraktarit", (1945), që u shfaqën në grupet amatore në Shkodër në vitet 1920 - 1930.

Dom Ndre Zadeja kontributin kryesor e dha në fushën e dramaturgjisë. Ai krijoi me sukses në llojin e melodramës një varg pjesësh teatrale: "Ora e Shqypnisë" (1919), "Hije të zeza" (1921), "Rozafa" (1936), "Ruba e kuqe"(1937), "Rrethimi i Shkodrës 1477-1478" (1937) e të tjera, disa prej



të cilave u vunë në skenë dhe patën jehonë në Shkodër e gjetiu.

Andrea Skanjeti shkruan 22 drama që në 1918, si: "Ali pashë Tepelena dhe suliotët", "Andrra e 500 vjetëve", duke vazhduar edhe mbas 1944 me melodramën "Dasma", dramën "Nora", "Rozafa" e të tjera.

Mbas viteve 1944 në dramet e autorëve shkodranë me gjithë frymen ideologjike, të kushtëzuar, u krijuan drama si "Halili dhe Hajrija", (1949), "Toka e jonë", (1955), "Detyra", (1958), "Përkolgjinajt", (1966), "Kunora e Nurijes", "Lulet e shegës", (1976), "Përmbysja e madhe", (1978) të Kole Jakovës.

Xhemal Broja, një nga themeluesit e degës së dramaturgjisë pranë Institutit të Lartë të Arteve, gjatë viteve 1950-1960, shkruan dramat "Përleshja", "Nën okupacion", "Majlinda", "Dragoi i Dragobisë",

"Dritë hije" si dhe përkthen vepra të dramaturgjisë botërore, si "Qeni i Kopështarit", "Valsi i Titanikut", "Shkolla e grave", e të tjera.

Fadil Kraja, një nga dramaturgët më të shquar të kësaj kohe, shkruan shumë drama e komedi, që më të shquar do të ishin "Fisheku në pajë", (1966), "Sinjalet e natës", (1972), "Shpartallimi", (1977), "Baca i Gjetajve", "Gjaku i Arbërit", (1983), "Djem të mbarë", "Çështja e Blertës", "Flamur në dasem", "Rozafa", "Kur flasin zemrat", "Luani i shtëpisë", "Çështje familjare", e të tjera, të vëna në skenë kryesisht nga trupa e aktorëve të Teatrit "Migjeni".

Fadil Paçrami, një autor shkodran, do të shkruajë dramat: "Shtëpia në bulevard", "Ngjarje në fabrikë", "Çështja e inxhinier Saimirit" e të tjera, që do vihen në skenë nga Teatri Popullor Tiranë, e të tjera.

Martin Camaj lëvroi edhe gjininë e dramës, ku mund të veçoheshin "Loja e mbasdrekës", (Mynih, 1981), si dhe "Kandili argjendit", (Kozencë, 1993)

Dramaturgjia pas v. 1990 në Shkodër, e çliruar nga kufizimet estetiko- doktrinare, bën përpjekje për të aplikuar forma dhe tipa të larmishëm, në rrjedhat bashkëkohore, duke thyer kornizat e vendosura më parë.

Fadil Kraja shkruan dramat: "Heshtja që të ther shpirtin", (1999);

Serafin Fanko dramet "Çmurosja", "Quo Vadis", "Pse?", "Trokitje në dyert e dhimbjes";

Stefan Çapaliku, përfaqësohet me dramat: "Ptesë për darkë", "Utopos", "Këpucët", "Ballkan ekspres", "Një ëngjëll në katin e njëmbëdhjetë", "Allegreto Albania", "Putargat e thata", e të tjera. Ai është i nominuar për çmimin "Europa Prize of Theater for the Neë Theater Realities" (Çmimi Evropian për Teatrin e Ri). Si dramaturg u nderua me çmimin e autorit, më të mirë shqiptar, në vitet: 1995, 2003, 2007, 2012, 2016.

Gazmend Krasniqi, në v. 2006 boton dramën "Tri drama", (çmim në konkursin mbarëkombëtar Albdramatika në vitet 2003 dhe 2007), e cila është vënë në skenën e Teatrit "Migjeni", dramën "Koncerti", që ka fituar çmim në konkursin mbarëkombëtar "Katarina Josipi", Prishtinë, 2008, e të tjera.

Drama e Mustaf Tukaj "Rrënjët e dashurisë" vihet me sukses në skenën e Teatrit "Migjeni". Me dramën "Një fund i tillë", (1985) fiton çmimin e parë në një konkurs. Më 2013 me dramën "Të ftuarit", nderohet me çmim të dytë.

Albri Brahusa ka shkruar dramat "Përrallat gënjejnë", "Vizita e fundit" dhe "Ishulli i Shitenit", të vëna në skenë në Teatrin "Migjeni". Në vitin 2002 "Vizita e Fundit" u vë në skenë në italisht, në Trento, Itali, nga Compagnia dell Attimo, me rregji të H. Çili

Shkrimtarja ZENEPE DIBRA

17 Fruer 1989

Këtë datë po e mbaj si titull shkrimi, e në fund, po vendos respektivën, pas 136 vitesh.....

Ishte vjeti 1902, - kështu shkruan piktori i famëshëm Simon Rrota në librin e tij, "Po shkruaj për vedi e Shkodren"- kur vllau jëm Ndoci u largue nga shpija për me ndjekë rrugën e meshtarisë në Kuvendin e Françeskanëve, simbas deshirit të tij, megjithëse baba e pat kundërshtue qyshë një vjetë përpara, por ai kishte cak-tue me u largue përgjithmonë prej gjindve të vet. Ky largim ndodhi me 28. 8. 1902, e sot emni i tij, si meshtar, asht Pater Justin Rrota.

Ajo dite kje një gja shumë e përmallshme për ne të gjithë, kur për të mbra-men herë na rroku [përqafoj] se e dinte qi në shpi të prindve nuk do të kthente ma. Ndër ata qi u ndodhen aty në atë moment aq të përmallshëm, e qi ishte ma i prekun se të gjithë, përveç prinve, ishe unë, tue mendue se qysh me atë ditë do të shkëputeshim me shoqi shojnë, e se me largimin e tij unë do të mbetëshe vetëm në shpi, përveç një vëllaut të vogël, Gjonit, e dy motrave.

Kurse një vjetë ma përpara, ishte nisë vllau ma i madh Kola, për në Klagenfurt [Austri] për me ndjekë mësimet e nalta në degen normale për mësues. Pra, me pak fjalë, unë vllazen të përshtatshem për moshen tëme nuk kishe ma e secili prej tyne kishte zgjedhë karrieren e vet. Po unë çka do të bajshe në atë moment aq të kritikshem? Kurrja tjetër veç se edhe unë do të kqyrsh me gjetë një rrugë, njashtu si banë vllaznit e mij.

Shkodër 13/IV/1958**I dashuni Mjeshtëri,**

Neser kini ditën e emnit. Ju uroj jetë të gjatë, shëndet të plotë, si gjithëherë, për të mirën, të mbarën dhe lulëzimin e gjuhës dhe të letërsisë sonë. E gëzofshit.

Kjo e kremte e Jueja koinçidon me ditën e lindjes sime. Prandaj edhe nuk e harroj.

(Shënimi im: Asokohe, në jetën qytetare shkodrane, bashkësitë i dinin ditët e festave respektive, madje, shkëmbenin vizita në mes vedit, katolikët, më së shumëti, festonin ditën e Emnit, do të thotë, kur lindnin, në pagëzim merrnin një emër shenjti...dhe Kastrati, ishte i vëmendshëm ta uronte për "emer").

Shkodër, 7/III/1959**I dashuni Jup,**

Të falënderoj për vizitë të datëlindjes – dico 70 a! Por vizitat konvencionale të rasavet mue nuk më knënaqin gjithaqë: Dëshiroj, të kemi kohë dhe oportunitet me rrahë çashtje një grimë ma të nalta, se ritualet e këtyne rasave: Punë s[....]et, punë shiut, punë motit...

Nejse: unë qeshë kondend edhe ashtu; pse mue m'u duk puna – edhe m'a kanë b'a fort mirë miqt! – kahë nuk pashë për atë rasë posë teje, tjetërken, as nuk mora prej miqsh një urim. I thashë vetes, se tashma ishem ba i tepërt mbi fëtyrë të botës: Ishte

koha t'i a liroj vendin tjerëvet. Aman, sa mirë i b'ajn nierit edhe deluzjonet e jetës!...

Ndiej, Jup! Përrallojn, se paska vajtë e h'y në një restaurant një i shkundun, por fort fjalëmadh e krenar. Me z'a të naltë, sa vuni kambën në salën e klientavet, ku ishin grumbullue e po hajshin se i cili në punë e xhep të vet, me z'a me u ndie prej të gjithëvet, i a ban kamerjerit, që ishte tue i b'a gadi vendin në një tavolinë në mjesh së tjeresh: "A keni mish pulet?" – Si urdhënon, Zotni. – A keni edhe venë të vjetrë "Chianti", dhe amëlcinë, e pemë e duhan "kuba", e ... – Mandej, i thotë në vesh kamerjerit: A m'a bjen do bukë e djathë dhe një gotë ujë!..... – Dhe mbaroi punë atë ditë me kaq!



Ndiç!

Unë të shkruaj kështu, për gaz; që të qeshish pak, dhe të fillojsh qyshë tash, me njohtun shekullin! Të b'ajn mirë, fort mirë, deluzjonet e jetës!

...

Më jep lajme të lëvizjes së jetës intelektuale, mbrenda e jashta Shqipniet. Jam kënaq tue këndue artikujt e Buletinit t'Universitetit n.I

Shëndet e të mira e punë të mbarë! Ç'ka je tue punue?

firma e P. Justinit

Shkodër me 16/II/1960**I dashuni Mjeshtëri,**

Nesër Ju kremtoni 71 vjetorin e ditëlindjes Suej. Meqenëse unë nuk kam mundësi të vij, më lejoni, që me anë të

kësaj letre të Ju uroj jetë e shëndet për të mirën dhe të mbarën e gjuhës amtare dhe të letërsisë shqipe.

U b'afshit njëqind vjeç! Veprat e Jueja të çmueshme dhe të dobishme, të shtohen vazhdimisht, që të pasunojnë, herëmbashere, bibliotekën albanologjike, shkencore dhe artistike.

Shumë shëndet dhe punë të mbarë:

(Jup Kastrati)

firma e J. Kastratit

Shkodër, 18/II/1961.**Fort i dashuni Jup,**

Ndërsa unë vetë përshkoheshe në perjudhën tragjike të dekës së vëllaut, qe se korrjeri më lajmon të zhdukunt e papritun, të thuesh, të së shuemes Laure!

E besoj dhimbën e ziun që ky i pari fëmijë, sado endë foshnje pakë muejsh, do të ketë veshë familjen mbarë.

Ngushëllimet pra, e përdhimbtime të mia ma të sinçerta, Ty dhe pjesëtarëvet të

FËMIJË PORSA 6 MUEJSH.

Fruer 1961**(Shënimi im)**

Ja si është jeta, ajo rrjedh sipas disa ligjësive, ashtu siç lind njeriu nëpërmjet dhimbjeve, ashtu vuan edhe për të vdekë dhe ato që mbesin pas, vuajnë thuajse më shumë.

Piktori Simon Rrota vdiq me 27 janar 1961, pak më përpara se Padër Justini të kishte ditëlindjen dhe, Kastrati, - me siguri siç del edhe nga letërshkrimet këtu - e kishte profesor, koleg dhe mik shtëpie, prandaj, e ka vuajtur vdekjen e Simonit por, për vehte ishte në halle të mëdha, Laura e tij, i ka lënë një gollë të madhe, e thotë vetë Profesor Jupi.

Se, ja:**Shkodër me, 12/III/1961.****I dashuni Mjeshtëri,**

Ka kohë që kam marrë letrën Tuej ngushëlluese të datës 18/II/1961 si edhe epitafin që kini pasë mirësinë me b'a për të shkretën Laura, që u shue pa i mbushë njëmbëdhjetë muej. Më falni që s'Ju kam falënderue për këtë korrektesën Tuejën, por vdekja e parakohëshme e shpirtit tonë të njomë na ka lanë një gollë kaq të madhe, pikëllimi i madh që na k'a mbulue dhe kobi që na ra kresë pa pritë pa kujtue na ka vorfnue kaq shumë, sa që fjala s'asht në gjendje me e paraqitë këtë humbje të pazavensueshme dhe këtë dhimbë e brengë të thellë shpirtënore. Prandaj, do të më falni, që ende s'kam mujtë me Ju a daktilografue tregimin Tuej. Besoj se javën tjetër do t'ia ap Paulinit...

Të fala me shëndet :

(Jup Kastrati)

firma e Kastratit

Dhe Padër Justini, i mbrujtun me besimin kristian dhe në vobektësinë e Shën Françeskut, vazhdon ta ngushëllloi profesor Kastratin për hallin që i rá, por edhe vetë ishte nën pikëllim për vëllaun e tij – Simonin – kur me, 18/III/, i drejtohet si françeskan, Kastratit në hall, kështu:

Jup i dashtun,

Kështu pra, e paska jeta; d.m.th. Kjo e tokës!


Po shí njetëherë kur kujton njeri, se i ka diçka për fije punët, pa pritë pa kujtue del çka i shpartallisë, tue i trandë me temel!

Edhe mue, gadi mbrenda asaj perjudhe tragjike, ndërsa Tý të takoi me t'u da dysh zemra, shkajku i të zhdukunit të papritun, të të shuemes Laure; po njaso ditsh gati më rá deka e vëllaut, të vetmit të thuesh qi kishem, e cila m'a vorfnoi jetën. ...

Por vall, morë Jup, a të ka rá me i a paraqitë Zotit ndonjë herë çashtjen, pse ky Krijuesi, Zoti absolut i rrozullimit, - kështu të flas unë Tý këtu, mbassi nuk më mbushet mendja kurr, se kam fjalë e punë me një ateist a nihilist të tërbuem – ky Zot, po thom – qi doemos do të jetë i mirë e i dashtun tejët ndaj krijatyrët e veta; pse Ky u a çon këtyne të bijvet të vet këta kryqa dërmuesë, në kundërshtim flagrant me mirsin e vet?....

Aman morë Jup, mos të rrijm n'andërr në një punë, ku është çashtja e amëshimit. Edhe, po u gabue një herë rruga, nuk ndreqet ma kurr, ma kurr!

Dhe, në kjoftë se më sheh mue këtu



ndry mbrenda murevet të lëmashkta të kuvendit, pa kurrken temin për ngjat, dije se vetëm ky mendim i amshimit, vetëm për me i u bâ gadi këtij hapi kaqë të randsishëm e deciziv, unë gjindem qyshë në moshën teme rinore.....

P. Justini
firma e P. Justinit

Episodi të fundit.

Në "EPISTULAR-in" në mes Padër Justin dhe Profesorit Jup Kastrati, këmbimi i letrave të mbrame, mban datën: Shkodrë, 2/II/1964, shkruar nga P. Justini, i cili ndërmjet të tjerave...ja, çfarë i shkruan Kastratit :

... mos të kishem uzdajë, se do të mujshem ndonjëherë me e shtypë veprën teme, tashma bâ legjendare "GJUHA SHQIPE", unë me kaq paçë rasë të kuptoj kuartë, ku jam, tue e kuptue mirë atë status questionis (situatën e çështjes. Në, fusnotë), për të cilin kishem dyshime të

forta! ... Kam mendue, t'i bâ qytetit tim një shërbim me botimin e këtyne fletvet linguistike, posaçë arsimtarve të krahitinë, tue u a kushtue mundin e sa vjetve, për me u ndihmue në mësimin e Shqipës së dashunë. Por s'paskam kjenë kuptue!

Jam plakë tashma, prandej mbaje në mendë, se jeta e njerit po ishte "një varg deluzjonesh". Fortuna, che siamo avezzi (për fat, jemi mësuar. Në, fusnotë) – kështu thotë diku A. Manzoni.

Me kaq, Të falem
P. Justini

Në mbyllje,

Artikulli i Jup Kastratit: Justin Rrota – në 75 - vjetorin e lindjes, botuar në "Studime filologjike", nr. 2, Tiranë, 1964, fq. 204-206

JUSTIN RROTA – NË 75 VJETORIN E LINDJES

Më 17 shkurt, gjuhëtari dhe letrari

Justin Rrota kremtoj 75 vjetorin e lindjes. Krijimtaria e tij shkencore dhe letrare përfshin një kohë prej pesëdhjetë vjetësh (1914 - 1964), gjatë se cilës ai i ka dhanë kontribute me vlerë në mënyrë të veçantë studimeve të gramatikës shqipe ...

Vitet e fundit ai ka përgatitur një tekst të haptë mbi gjuhën shqipe, tue përfshi leksikon, fonetikën, morfologjinë dhe sintaksën. Aty meritonjë të përmenden në mënyrë të veçantë vëzhgimet me interes që ai ka shkruar tue ba mbi fakte të ndryshme morfologjike e materialit që ai ka mbledhë.

Jup Kastrati

Epilog

Që, prej disa muajsh, institucionet akademike të vendit tonë, institucionet kulturore dhe arsimore, kanë në duar, një vepër unike e të një lloji të pa lëvruar në vendin tonë, "EPISTULAR" Prof. Jup Kastrati – At Justin Rrota (1951-1964)

Janë letërshkrime në mes dy personalitetve të fushës së gjuhësisë, në lëmi të ndryshme të saj.

Një frat i shkolluar në Austri, e më vonë profesor në Liceun "Ilirikum" të Etënve Françeskan në Shkodër dhe të një pedagogu të ri shkodran, të Institutit Pedagogjik të Shkodrës, që i lidhnin bashkë një miqësi qytetare familjare, një dëshirë të kontribonin në fushën e arsimimit të nxanësve dhe studentëve, asokohe, në hapat e parë të zhvillimit të arsimit, të Shqipërisë së pasluftës.

Është disi e çuditëshme "alkimia" në mes tyre, që rrokë të gjithë problematikën e zhvillimit të gjuhësisë dhe të letërsisë, të botimeve në këto fusha, mënyra e shkrimit të letrave (271 letra në mes vedit), thuajse, sa mbërrin njera – tjetra kthehet saora, gjuha e bukur që ato përdorin, një shkoderanishte e kulluar, e problematika të tjera që janë në libër, që nuk mund të paraqiten këtu, por vetëm duhen lexuar me laps në dorë.

Fjalët e mia

Libri duhet të përthehet në shumë prizma, me kënd të ngushtë e të gjanë, duhen vëzhguar në shumë fusha të studimeve, njerzore, shoqërore, antropologjike, filozofike, humane, shkencore por jo ma pak, historike. Në libër ka histori njerzore, në mes profesorësh vendas e të huaj, ngjarje dhe data, lindje dhe vdekje, e sa shumë të tjera, sosh.

Unë do ta bëj!

Le ti bie ndërmendë edhe çdo shkoderani, çdo shqiptari !

Shkodër me, 17 shkurt 2025, - 136 vite "dritë" nga lindja e P. Justin Rrota.

Leonard Qyteza

(Vijon nga faqja 11)

Këtë do ta marrin ata që dalin në Shëngjergj, se një pjesë do shkojnë në botën tjetër, pa e arritur këtë gëzim! Ka skeptik, që as këtë nuk e besojnë, thonë se premtimet nuk mbahen, në mendje ju vijmë si shëndetësia falas, kjo sa here marrin ilaçet apo kryejnë ndonjë vizitë. Këto premtime u fishkëllojnë në vesh, ashtu si dhjetëra e dhjetëra premtime të pa mbajtura.

Të gjithë e kujtojmë premtimin për hapjen e 300 mijë vende pune. Ndodhi e kundërta se u larguan mbi 500 mijë shqiptar dhe 90 për qind ishin mosha më vitale për punë. Tani kemi mbetur nga dy pleq për shtëpi, as në varr nuk ka kush na përcjelle. Donë Zotit, që edhe shërbimet funerale të mos jua japin PPP. Hapja e vendeve të punës dhe punësimi në Shqipëri i tyre, do rriteshin kontributet, si rrjedhojë edhe fondet për pensionet. Në kushtet aktuale, qeveria kishte mundësi në planin e buxhetit të vitit 2025, të planifikonte një shumë parash për rritjen e pensioneve, të paktën 10 perqind, ashtu siç bëri Kosova, e cila i rriti 20 për qind pensionet e hoqi njëherë e mirë nga lëmosha e banuesve, për shpirtin e qeverise e të parlamentit, siç ndodh tek ne.

Lind pyetja, nga do të gjendeshin? Po,

gjenden, vetëm duhet të jetë vullneti i mirë, nga ulja e shpenzimeve të luksit, sidomos në blerjen veturash apo marrje me qira të tyre, orendi të zyrave e të tjera. Ulja e PPP, të cilat gllabërojnë gjysmën e buxhetit, ulja informalitetit, heqja e përfitimeve të deputetëve e qeveritarëve, për udhëtime e dieta, karburant, telefona, qera e të tjera. Gjohat, të cilat janë kryer nga papërgjegjshmëria e drejtorëve nga baza deri në qeveri, duke larguar punonjës nga puna, të cilët janë kthyer nga drejtësia, të larguar pa drejtësisht. Për një vend pune janë paguar dy punonjës. Shifra është alarmante, kjo shifër duhet paguar nga personat përgjegjës dhe jo nga taksat tona. Më e rënda është në sistemin e drejtësisë, gjyqtaret e larguar e kanë fituar në gjykata dhe arrin në 8 milion ero. Gjohat nga arbitrazhi ndërkombehtarë e të tjera, do të siguronte rritje të pensioneve mbi 10 për qind. Nuk u ndala te shifrat, për të mos bërë shkrimin statistikë e të mërzhishëm për lexuesin. Ashtu siç veprojnë edhe me shtresa të tjera, madje edhe në fatkeqësi, qeveritarët tonë përqeshin, bulëzojnë. Kështu tallen me protestat e pensionistëve, nuk marrin mundimin t'i takojnë, madje thonë se, nuk kanë me çfarë merren dalin me kalua kohën. Arrijnë deri aty sa thonë nuk qëndrojnë shumë, se janë me prostate e të tjera.

Faktor që i rendojnë pensionistet, janë sorollatjet në banka. Çdo 6 muaj, pensionistet duhet të paraqiten në banka, për të vërtetuar se jemi gjallë!!! Termi i gjallës është i pa përshtatshëm dhe duhet gjetur një fjalë më e përshtatshme. Sot çdo gjë është e dixhitalizuar, nuk ka nevojë fare të shkosh në bankë. Po të njëjtën gjë mund të themi për bonuset, të cilët jepen për festat e fundvitit. Pse mos të jepet kjo shumë e ndarë në muaj? Konkretisht pensionisti që merre 20 000 lekë në muaj? Të marrë 21 250 lekë në muaj, këto ti përdore sipas mundësive të tij. Dhe e dine se këtë sasi parash e merr çdo muaj. Paradoksi tjetër është se, qeveria thotë: Bonusi i Pranverës do të jepet në varësi të realizimit të planit! Se cili është, kontributi i pensionistëve në realizimin e planit? Këtë e di vetëm një mendje e sëmurë e përdorur për të hedhur hi syve pensionistëve, sa të kalojmë muajin e majit. Po shqyr plani u realizua në muajin mars!!!

Shumica e pensionistëve që punojnë janë në bujqësi, se vetëm pensioniste kanë mbetur, madje edhe ato, prodhimet i hedhin në kanal se, tregu mbushet me prodhime importi. Në buxhetin e vitit 2025, bujqësia është pare me syrin e njerkes. Dhënia përparësi subvencioneve në bujqësi, do ndikonte në rritjen e prodhimit, do ndihmonte edhe pensionistët si fuqi

punëtorë e këtij sektori.

Për pensionistët problem është shëndetësia: Për të bërë një vizitë te specialistët duhet pritur rreth një muaj. Ndërsa për të bërë një rezonancë, duhet pritur mbi tre muaj në institucionet shtetërore. Radha të vjen pasi të kesh shkuar në botën tjetër! Po të njëjta gjë mund të themi edhe për analizat dhe ilaçet e rimbursuara, të cilat vijmë nga India e Bangladeshi e të tjera. Po bëhen rreth 15 vite, që po tallen me 800 mijë pensioniste.

Çmimet rriten në progres gjeometrik, ndërsa pensionet në vend numëro. Shumë vite u bënë që pensionistët, nuk mund të habiten, që pas këtyre viteve, premtimet për ta janë pensione të vogla, të vonuara, dhe të pa mjaftueshme. Ka ardhur koha që pensionistet të lënë pas dallimet partiake e të votojnë ato subjekte, ku në programin e tyre kanë. Rritjen e pensioneve, kartën e konsumatorit e mbi të gjitha prosperitetin e pensionistëve. Duhet që ne, pensionistet Dukagjinat e gjithë votuasit të votojm për kandidatet, të cilët vijmë nga kjo trevë. Të perfaqsohemi në parlamentin e ardhshëm, si asnjë here tjetër, me burrat, grate, djem e vajza të kësaj treve të mrekulluashme.

Të zgjedhim më të mirët e më të mirëve, me 11 maj 2024!

Përgatiti NDUE ZIÇI, mars 2025



Nga FILIP GURAZIU

**Dita e Kujtesës së Krimin Komunist
26 shkurt 1951**

MASAKRA E 26 SHKURTIT 1951

Portrete hjenash, me sy çakajsh.
Britma egersinash, t'unshëm për gjak.
Krizma shulash, përplasje dyersh.
Gjallesa me sy t'kuq t'fundit të ferrit.
Pa frymë t'len bloza e zezë e tmerrit,

Vetem drita e mendimit ndriçon...,
dhe nekranin e kuq të historisë,
me gjak të pafajshëm të spërkatur
i plotë prej fillimit, projektohet
filmi i gjatë..., i jetës së shkurtë ...
Oh, sa kujtime...Oh, sa dashuni,
Oh sa dhimbje, për familje e fëmij...

Zhurma uluritse e kamionave,
shoqnon mjerimin e viktimave.
Telat me gjëmba pescepash
mbërthejnë duer, gjoks e fyt,
lidhin s'bashku burrat n'pafundësi,
vetem shpirtinat e tyne plot virtyt,
fluturojnë n'jetesë të lirë n'ajri

Drita e shpirtit vazhdon ndriçimin,
vajza, djali, grueja, nana, baba...,
me buzëqeshje të trishtë i përqafojnë...
Pa za, në heshtje por vetem me shikimin,
përmallshëm me dashuni vajtuese i sigurojnë:
Gjithënjë me ju, përjetësisht me ne!

Pushon zhurma, fillojnë çirret,
kondaket e pushkve sulmojnë,
gropa me baltë ska vend ma,
breshni plumash prej nalt vërshojnë,
kafkat shpohen, trupat përdhunohen
jetët shuhen e dërmohen.

Muzika e heshtjes makabër,
shoqnoi masakren deri n'fund
Terrori triumfoi mbi pafajsinë.
Nata e zezë shpërndau ligësinë,
deri atje, atje...në sallën e Biorosë,
ku lugetnit me ftyrë njeriu,
të harlisun prej drogës së gjakut,
nën ekstazën e shijes së krimin,
hodhë vallen rituale t'vampirit.
nen ritmin e ulurimave t'Lavirit

Nuk ka ma as edhe dritë mendimi,
ka vetem vajtim e lutje mallkimi,
për ato hjena t'kuqe me sy çakalli
që masakruen një popull për s'gjalli.



nga MEVLUD BUCI

POEZI SATIRIKE

Mos u mburrni pa parë fundin

Ç'janë këta, ç'janë këta?
Bëjnë akuza or marshall!
Natë e ditë po u plas buza
Veç dërdëllisje e veç akuza
Vallë si e kuptojmë të vërtetën?
Me grindje e vjedhje e çmojnë jetën
Çështë kjo dramë e kjo marrëzi
A mbahen pozitat me dredhi?
Gjithësëkushi fort çuditet
Çështë kjo fares, që veç koritet
Ta mësojnë kohën e të vërtetën
Kush njih Krishtin e Muhametin
Nuk mbahen postet jo me dredhi
Hiqen hyjnor e dalin lubi
Sa të ngjiten në një pozitë
Veç bëjnë vjedhje, bëjnë dredhitë
Çështë kjo farsë e kjo hata?
Ku i çon mushka or vëlla?

Këta "hyjnor", këta fjalamanë
Janë Kainë, janë shejtanë
Për të bërë vetëm pasuri
Janë ngjit lart në qeveri
Hiqen të ditur, shpëtimtarë
Llafollogë, kopukë e zuzarë
Me plot bujë tundin ekranet
Këta Magbeth- motër kokanët
Këta Jago- të Shekspirit
Janë bash gena të vampirit
Janë të lindur për grabitje
Karrieristë vetëm për ngjitje
S' njohin qytetin e as fshatin
Mburrën me poste pa parë fundin
Këta janë farsa e katilit
T'mos harrojnë fjalën e Eskilit
Me Eskilin botën e tundin
Mos u mburrni pa parë fundin !

FABUL

Bilibli dhe palloi...

U zunë shpendët tek një krua
Një bilbil mali me një pallua
U hodh e tha, më urti bilbili
Me shoshë, o pallua - nuk mbulohet dielli
Gjetkë tek brraka, fort u zemërua
Pendëbukuri- mendjëlehti pallua
Me cektësi, me mendje si flutura
Jam më i zoti,- tha,- kam pendët e bukura
Soji i bilbilit bashkë me shpendët
Thonë: O pallua të rrofshin pendët.



nga GJON KOSTERI

Moj Shqipni, moj emen madhe

Moj Shqipni, moj emen madhe,
Qe stu ndan kurr vuajtje e halle,
Mijra vjet Romen tek dera,
Tuj t' ndryshue tradita e vlera,
Mrapa zbrisnin prej n' Rusi,
Serbo sllavt tuj shty n' kufi,
Peseqin vjet anadollaku,
Si mortaj e zeze te praku,
Pesdhjet vjet klika e kremlinit,
Ma e vshtira e krejt njerzimit,
Sa filloj dielli me t' ra,
Plaget e trupit me ti tha,
Nxorren krye djaj e barbar,
Ma hajduta e ma kusar,
Ma t' pa shpirt e ma çnjerzor,
se pushtuesat shekullor,
Që nuk njohin as Zot në qiell,
Tuj t' plaçkit ditën për diell,
Helm në shpirt e thik mas shpine,
T' kan afrue krejt pran gremine.
T' kishte goj toka me fol, / Mbi kto troje çfar ka ndodh,
Çfar masakrash n' jet ka pa, / Se sa her me gjak asht la,
Për beteja e tragjedi, / Për komplete e pabesi,
Sa ushtri mrapa jan kthye, / Sa jan pre e mbet pa krye,
Sa jet njerzish shkuen per kot,
Sa jan derdhun gjak e lot, / Sa tradhtar n' para jan ble,
Sa marrveshje 'n bes jan pre,
Nuk ka dor, qe mund me i shkrua,
S' mundet kush per me i besue,
A thue gjakun ta helmuen,
A thue mendjen ta marruen,
Si spo gjindet kurrkun çare,
Me bashkue trojet Shqiptare,
Me i pajtue shqiptart nderveti,
Thue se jan tjeret planeti.
O Shqiptar, vllaznit e mi, / Në past met fije burri,
Gjak Arbnor ne ju past Damari,
Shpirt e zemer prej Shqiptari,
Banju bashk pash t' madhin Zot,
Mund e djers mos t' na shkojn kot,
E n' ardh dita me gjyuke,
T' part e tu n' kuvend me i çue,
Mos i mbytni shpirtin n' uj,
Por shpetoni vendin tuej,
Tuj i zgjedh njerzit ma t' mir,
Qe u ka met pak gjak e ftyr,
Mos tu a vjellin djers e gjok,
E s' kerkojn për me marr hak,
Por për t' mira bjeni në një fjal,
Si me pshtue ket Shqiptari,
Prej hajdutit e kusarit,
Prej t' pashpirtit e prej barbarit,
E t' festojm bashk ta bajm dasmen,
Se jem Shqiptar, tan jena vllazen.

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Suela Ndoja, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia
Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja,
Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza,
Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**MUNDËSUAN BOTIMIN
VËLLEZËRIT, ZEF,
KRISTJAN E KLADIO
PALI, ME BANIM NE
KOMUNEN CUNEO,
ITALI**

